



Paneli këshilldhënës për të drejtat e njeriut

Building D, UNMIK HQ Prishtinë/Priština, Kosovo | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

Raporti vjetor 2011



Parathënie

Në vitin e katërt të aktiviteteve të tij, Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut vazhdoi me misionin e tij të përgjithshëm në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12. Sikurse në vitin 2010, Paneli nxori shumë vendime dh mendime të rëndësishme, duke konsoliduar jurisprudencën e tij dhe duke iu përgjigjur çështjeve të reja mbi përgjegjësinë për të drejtat e njeriut që paraqiteshin në lëndët nën shqyrtim. Rezultati i punës së Panelit dhe i Sekretariatit të tij është paraqitur më hollësisht në këtë raport.

Bashkëpunimi ndërmjet UNMIK-ut dhe Panelit vazhdoi pa probleme. Përkundër numrit të madh të ankesave që i janë komunikuar Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) në faza të ndryshme të procedurës duke kërkuar komentet e UNMIK-ut, Paneli ka pranuar përgjigjet me kohë dhe të përgatitur në mënyrë profesionale. Paneli gjithashtu falënderon përpjekjet e bëra nga ana e UNMIK-ut për t'i siguruar Panelit dokumentacionin e nevojshëm, veçanërisht dosjet e policisë dhe dosjet tjera lidhur me hetimin e lëndëve të vrasjeve dhe personave të zhdukur. Megjithatë, qasja në këto dosje, shumica e të cilave aktualisht janë në posedim të Misionit të EULEX-it në Kosovë, nuk varet gjithmonë vetëm nga përpjekjet e UNMIK-ut. Gjatë vitit, Paneli është njoftuar se UNMIK-u ishte përballur me probleme të shumta lidhur me qasjen në ish dosjet e tij, një situatë që akoma vazhdon pa zgjidhje. Pa pasur qasje në dosjet e plota, ashtu siç kanë ekzistuar gjatë kohës kur UNMIK-u ishte përgjegjës për hetimet, Paneli nuk mund të përmbushë mandatin e tij në mënyrën e duhur.

Derisa po theksojmë relacionet e mira të bashkëpunimit me UNMIK-un, Paneli gjithashtu duhet të theksojë se për një kohë tanimë PSSP-ja nuk u është përgjigjur mendimeve të dhëna nga Paneli në mënyrën siç kërkohet me Rregulloren 2006/12.

Paneli nuk mund të mbështetet gjithmonë vetëm në informacionet dhe materialet e pranura nga ankuesit dhe UNMIK-u; në të shumtën e rasteve është po ashtu e nevojshme të kërkohen informacione nga institucionet tjera ndërkombëtare dhe vendore që punojnë në Kosovë. Gjatë viteve të fundit, ashtu si në vitet e mëparshme, Paneli ka qenë në gjendje përgjithësisht që të llogarisë në bashkëpunimin e tyre të mirë. Në këtë kontekst, Paneli falënderon Agjencinë Kosovare të Pronës, Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, gjykatat e rregullta, si dhe Prokurorinë Publike të Qarkut në Prishtinë. Pa një bashkëpunim të tillë, një shqyrtim i duhur i lëndëve të shumta do të ishte shumë i vështirë, për të mos thënë i pamundur.

Gjatë vitit të kaluar, Paneli, bazuar në përvojën e tij të mëparshme, ka bërë përmirësime të ndryshme për sa i përket procedurave të brendshme të punës gjatë seancave të tij mujore në Prishtinë. Ka shfrytëzuar shumë më tepër mjetet elektronike të komunikimit në periudhat ndërmjet seancave të tij, për të diskutuar strategjinë e rasteve, dhe për të miratuar vendime. Këto ndryshime i kanë mundësuar Panelit të procedojë lëndët në mënyrë më efikase dhe të avancojë produktivitetin e tij të përgjithshëm.

Mungesa e stafit në Sekretariatit e Panelit dhe ardhjet e largimet e shpeshta të zyrtarëve ligjorë brenda Sekretariatit, kanë vazhduar të përbëjnë një problem të madh. Ardhjet dhe largimet e stafit gjithmonë pengojnë rrjedhën dhe vazhdimin e punës; mirëpo, problemi është gjithnjë e më akut duke ditur numrin e vogël të këtij ekipi.

Për të përmirësuar situatën pjesërisht, Paneli ka kërkuar të merr fonde financiare nga shtetet donatore, meqë tanimë për një kohë të gjatë është e qartë se është shumë vështirë të plotësohen zbrazëtitrat për sa ai përket plotësimi të Sekretariatit me staf brenda strukturave të buxhetit të UNMIK-ut. Në vitin 2009, si rezultat e përpjekjeve të tilla, Panelit i ofroi ndihmë një avokat i dërguar nga Qeveria finlandeze. Në vitin 2010, Suedia u pajtua të ofrojë ndihmë, dhe si rezultat i një marrëveshjeje të arritur në mes të Qeverisë suedeze dhe UNDP-së, një avokat tjetër filloi të punojë në Sekretariatit e Panelit. Mirëpo, kjo marrëveshje mbulonte vetë periudhën kohore prej majit 2011 deri në janar 2012. Për shkak se Qeveria suedeze përjashtimisht kuptoi nevojat e Panelit dhe rëndësinë e tij për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë (për të cilën ne jemi jashtëzakonisht mirënjohës), kjo ndihmë financiare është vazhduar edhe për një vit. Megjithatë, siç ka theksuar Paneli tanimë në raportet paraprahe, numri, intensiteti i punës dhe kompleksiteti i lëndëve akoma kërkojnë shtimin e një numri mjaft të madh të personelit ligjorë në Sekretariatit e HRAP-it. Së bashku me një numër të faktorëve të tjerë, mungesa e personelit të tillë e prolongon kohën që i nevojitet Panelit për përfundojë lëndët, dhe së këndejmi, zgjat periudhën deri kur Paneli do të jetë në gjendje të përfundojë zgjidhjen e rasteve të pakompletuara dhe të përfundojë aktivitetet e tij .

Për shkak të vëllimit të madh të lëndëve lidhur me ankesat për mungesën e hetimeve adekuate dhe efektive për vrasjet apo personat e zhdukur (dhe rëndësinë e madhe dhe natyrën e këtyre lëndëve), Paneli u kushton pjesën më të madhe të kohës së tij dhe mundin ankesave të tilla. Në vitin 2011 Paneli bëri përpjekje të konsiderueshme që PSSP-së t'ia komunikojë pjesën më të madhe të këtyre rasteve dhe të nxjerrë numër sa më të madh të mundshëm të vendimeve për pranueshmërinë e tyre pas shqyrtimit. Qëllimi i Panelit ka qenë të mbledhë të gjitha materialet që ka pasur mundësi t'i merr nga një numër mjaft i madh i rasteve të tilla, ashtu që të kuptojë më së miri tipin dhe llojin e çështjeve specifike që Paneli duhet trajtuar për bazueshmërinë e tyre. Pasi Paneli të ketë një pasqyrë të plotë për dokumentacionin që mund të presë ta marrë, atëherë fillon shtjellimin e thellë të mendimit për çështjet relevante para se të përpilojë mendimin përfundimtar për bazueshmërinë në këto raste.

Marek Novicki
 Kryetar
 Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut
 Mars 2012

Përmbajtja

Hyrja	5
Përbërja e Panelit	6
1.1. Anëtarëte Panelit	6
1.2. Stafi i Sekretariatit	8
1.2.1. Anëtarët e Sekretariatit në fund të 2011	8
1.2.2. Anëtarët e Sekretariatit që shërbyen gjatë 2011	9
2. Korniza rregullative	10
3.1. Rregullorja nr. 2006/12 dhe Urdhëresa administrative nr. 2009/1	10
3. Uebajti i Panelit	11
4. Numëri i lëndë e Panelit dhe statistikat	11
5.1. Të dhënat statistikore	13
5.2. Tendenca në numrin e përgjithshëm të lëndve dhe çështjet të tjera të rëndësishme	14
5.3. Mendimet dhe vendimet e Panelit sipas çështjes së trajtuar	16
5. Praktika gjyqësore	19
5.1. Çështjet e pranueshmërisë	20
5.2. Heqja e rasteve nga lista	22
5.3. Çështjet përmbajtëse	22
5.3.1. E drejta për të mos u trajtuar në mënyrë johumane apo degraduese – Neni 3 i KEDNJ	22
5.3.2. E drejta për gjykim të drejtë – Neni 6 § 1 i KEDNJ	24
Rekomandimet e Panelit	28
Mosreagimet publike të UNMIK-ut ndaj rekomandimeve të Panelit	29
6. Anekset	30
Aneksi A: Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12	31
Aneksi B: Urdhëresa administrative e UNMIK-ut nr. 2009/1, Implementimi i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut e datës 17 tetor 2009	39
Aneksi C: Ankesat e HRAP-it të pranuar sipas vitit	42
Aneksi D: Rastet e mbyllura të HRAP-it (të papranueshme ose mendimet për bazueshmërinë) sipas vitit	42
Aneksi E: Grafiku i HRAP-it për rrjedhën e lëndëve	43

1. Hyrje

1. Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (Paneli), i themeluar përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, të datës 23 mars 2006¹, ka vazhduar shqyrtimin e ankesave për shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) apo ato që i atribuohen atij gjatë vitit të katërt të funksionimit të tij në Prishtinë, Kosovë. Paneli mbetet mekanizimi i vetëm që merret me shkeljet e të drejtave të njeriut që pretendohet se janë bërë nga Misioni në terren i Kombeve të Bashkuara apo që i atribuohen atij.

Edhe pse Paneli nuk mund të urdhërojë kompensim ose ndihmë specifike, ai megjithatë mund të vendosë nëse UNMIK-u është përgjegjës për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe, nëse është, mund t'i bëjë rekomandime Përfaqësuesit Special të Kombeve të Bashkuara (PSSP) në Kosovë.

2. Me konstituimin e tërësishëm të Panelit në vitin 2011, ai arriti vitin më të suksesshëm deri më sot në procedimin e ankesave. Ky Raport vjetor mbulon periudhën prej 1 janarit 2011 deri në fund të 31 dhjetorit 2011, gjatë së cilës kohe Paneli ka mbajtur 11 seanca, nuk ka pranuar ankesa të reja,² dhe i ka komunikuar 117 raste PSSP-së për komentet e tij mbi pranueshmërinë dhe/ose bazueshmërinë e ankesave. Gjatë vitit 2011, Paneli gjithashtu miratoi 6 mendime mbi bazueshmërinë (lidhur me 46 ankesa), tutje konstatoi pranueshmërinë e 114 ankesave ose pranueshmërinë e pjesëshme, shpalli 50 ankesa të papranueshme dhe largoi nga lista 2 ankesa. Nga një numër i përgjithshëm i 526 ankesave të regjistruara, disa prej të cilave kishin të bënin me një numër të madh të ankuesve për të cilët ishin dhënë emrat, një numër i përgjithshëm prej 164 janë të mbyllura, derisa pjesa e mbetur prej 362 ankesave janë në pritje për shqyrtim në faza të ndryshme të procedurës. Paneli është akoma në pritje të përgjigjes publike të UNMIK-ut për rekomandimet që i ka bërë Paneli deri më sot.

3. Në vitin 2011, Paneli dhe Sekretariati kanë marrë fonde nga Qeveria suedeze për të punësuar një avokat shtesë për një periudhë prej 8 muajsh, kontrata e të cilit u menaxhua nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Së këndejmi, Qeveria suedeze u pajtua që të financojë një pjesëtar të stafit të Sekretariatit për një periudhë tjetër prej 12 muajsh, sërish nën menaxhimin UNDP-së. Pjesëtari i stafit fillon punën në fillim të 2012. Përveç kësaj, Divizioni i UNMIK-ut për Mbështetjen e Misionit e kanë përtërirë kontratën me Sekretariatit për shërbime nga jashtë të përkthimeve jokonfidenciale, për të zvogëluar grumbullin e përkthimeve të pakryera.

4. Paneli është takuar me homologët e tyre nga Paneli Shqyrtues për të Drejtat e Njeriut në EULEX, për të diskutuar çështje të interesit të ndërsjellë. Në emër të Panelit, Sekretariati kontaktoi me Zyrën e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, me Amnesty International dhe me Human Rights Watch. Përveç kësaj, anëtarët e Panelit dhe të

¹ Bashkëngjitur si shtojcë A.

² Në pajtim me Urdhëresën administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, afati kohor i pranimit të ankesave nga Paneli përfundoi më 31 mars 2010.

Sekretariatit u mbajtën prezantime studentëve vizitorë nga Qendra evropiane për studime të magjistraturës për të drejtat e njeriut dhe demokratizim, të vendosur në Venecie.

2. Përbërja e Panelit

2.1. Anëtarët e Panelit

5. Tre anëtarët e Panelit, të cilët janë emëruar nga Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut dhe janë (ri)emëruar nga PSSP-ja në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/11, duke filluar nga 1 janari 2011 ishin z. Marek Nowicki (Poloni), z. Paul Lemmens (Belgjikë). Znj. Christine Chinkin (Mbretëria e Bashkuar/Australi). Paneli zgjodhi z. Marek Nowicki Kryetar në janar të vitit 2008 dhe e rizgjodhi atë në po të njëjtën pozitë në vitin 2009, 2010 dhe 2011³.

6. Më tutje në tekst janë të dhënat biografike të anëtarëve të Panelit.

7. **Marek A. Nowicki** (janar 2007 – vazhdon) është shtetas i Polonisë dhe jurist i fushës së të drejtave të njeriut. Që nga viti 1987 është anëtar i Odës së Avokatëve të Varshavës.

8. Z. Nowicki ishte Avokati ndërkombëtar i Popullit në Kosovë, i emëruar nga Kombet e Bashkuara nga korriku i vitit 2000 deri në dhjetor 2005. Ai ka qenë anëtar i Komisionit evropian për të drejtat e njeriut në Strasburg nga marsi 1993 deri më 31 tetor 1999, dhe po ashtu ka qenë anëtar i Polonisë i Rrjetit të Bashkimit Evropian të ekspertëve të pavarur për të drejtat themelore, nga marsi 2003 deri në shtator 2006. Në vitin 2005 ai është emëruar nga Komisioni i ministrave si njëri prej kandidatëve për postin e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës.

9. Ai ishte njëri nga “juristët eminentë” të emëruar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës për të vlerësuar gjendjen ligjore dhe atë të të drejtave të njeriut në Moldavi (1994) dhe në Azerbejxhan (1997). Në vitin 1996 dhe 1998, Këshilli i Evropës i ka propozuar të shërbejë si ekspert i të drejtave të njeriut gjatë vlerësimit të përputhshmërisë së sistemit ligjor të Gjeorgjisë dhe të Federatës Ruse me standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ai ka punuar si ekspert i të drejtave të njeriut për Komisionin Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) dhe për Drejtorinë e përgjithshme për të drejtat e njeriut dhe çështjet ligjore të Këshillit të Evropës.

10. Ai ka qenë një ndër themeluesit e Fondacionit të Helsinkit për të drejtat e njeriut në Varshavë dhe kryetar i tij prej nëntorit 2003 deri në shkurt 2008. Ai është anëtar i Këshillit këshillëdhënës të Qendrës ndërkombëtare për mbrojtje ligjore të të drejtave të njeriut në Londër (INTERIGHTS). Z. Nowicki është autor i disa librave dhe i qindra artikujve për të drejtat e njeriut, të botuara në Poloni dhe në vendet tjera. Ai gjithashtu mban ligjërata për të drejtat e njeriut në universitetin “Collegium Civitas” në Varshavë.

³ Rregullorja e Punës së PKDNJ (HRAP), Rregulla 6.

11. **Paul Lemmens** (janar 2007- vazhdon) është shtetas i Belgjikës dhe gjyqtar në Këshillin e shtetit të Belgjikës, post ky që e ka mbajtur që nga viti 1994. Ai ka shërbyer në sektorin e Këshillit të shtetit që shqyrton përputhshmërinë e propozim-legjislaturës dhe propozim-rregulloreve me normat më të larta të së drejtës vendore dhe ndërkombëtare, si dhe në sektorin e së drejtës kontestimore të Këshillit të shtetit, e cila përbën Gjykatën Supreme Administrative të Belgjikës.

12. Që nga viti 1986, z. Lemmens po ashtu ka qenë profesor në Universitetin e Leuvenit, ku ligjëron të drejtën ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut. Ai gjithashtu ka ligjëruar të drejtën kushtetuese, procedurën civile dhe atë administrative. Po kështu, ai është autor i një numri librash dhe artikujsh për ligjet evropiane për të drejtat e njeriut. Ai është drejtor belg i Programit evropian të magistraturës për të drejtat e njeriut dhe demokratizim, program evropian ndëruniversitar me bazë në Venecie të Italisë. Z. Lemmens ka qenë anëtar i Komisioni të Belgjikës për mbrojtjen e të dhënave prej vitit 1987 deri në vitin 1997, dhe gjithashtu është anëtar i Komisionit shtetëror për të drejtat e fëmijës që nga viti 2007. Ai ka qenë ekspert i Këshillit të Evropës për studimin e përputhshmërisë të disa sistemeve shtetërore (të shteteve të Evropës qendrore dhe lindore) me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut gjatë viteve 1990-ta. Ai ka qenë eksperti i lartë i Belgjikës në grupin ligjor të ekspertëve të Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRALEX).

13. **Christine Chinkin** (shkurt 2010-vazhdon), me shtetësi të dyfishtë britaneze/australiane, anëtare e Akademisë Britaneze, aktualisht profesoreshë e së drejtës ndërkombëtare në Fakultetin Ekonomik të Londrës, dhe profesoreshë e së drejtës globale William C Cook në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Michigan-it. Ajo është anëtare e Odës së Avokatëve të Anglisë dhe Wales dhe anëtare akademike e Matrix Chambers. Ajo është diplomuar në drejtësi në Universitetin e Londrës, Yale dhe Sidneit dhe më parë ka mbajtur poste akademike me orar të plotë në Universitetin e Oxford-it, të Londrës, Sidneit dhe Southampton-it, Fakultetin e Drejtësisë në Nju Jork dhe në Universitetin Kombëtar të Singaporit.

14. Interesimin kryesor znj. Chinkin e ka në të drejtën ndërkombëtare publike, veçanërisht ligji për traktatet, të drejtat e njeriut, duke e vënë theksin në mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të grave dhe organizatave ndërkombëtare, dhe zgjidhjen e kontesteve vendore dhe ndërkombëtare. Ajo është autore e shumë artikujve për çështje të së drejtës ndërkombëtare publike dhe të drejtat e njeriut të grave, e ligjeve Halsbury të Australisë, E Drejta për Marrëdhënie të Jashtme (botimi i dytë 2001), Palët e Treta në të Drejtën Ndërkombëtare (1993), bashkautore e Zgjidhja e Kontesteve në Australi (botimi i dytë 2002), bashkautore e Kufijtë e të Drejtës Ndërkombëtare: Analizë femineiste (2000) dhe bashkautore e Krijimi i së Drejtës Ndërkombëtare (2007). Ajo është drejtoreshë e Asociacionit për studime të së drejtës ndërkombëtare. Në prill 2001 ajo u shpërblye me fletëlavdërimin e Shoqërisë Amerikane të së Drejtës Ndërkombëtare për 'kontribut të jashtëzakonshëm në arritjen e diturisë' dhe në vitin 2006 Medaljen e Shoqërisë Goler T. Butcher 'për kontribut të jashtëzakonshëm për zhvillimin apo realizimin efektiv të ligjit për të drejtat e njeriut' (me H. Charlesworth).

15. Znj. Chinkin ka qenë konsulente e së drejtës ndërkombëtare për Bankën e Azisë për Zhvillim; për trafikimin e grave në Zyrën e Komisionerit të Lartë të KB-së për të Drejtat e

Njeriut; për Marrëveshjet e Paqes dhe Çështjet Gjimore në Divizionin e KB-së për Avancimin e Gruas dhe për UNIFEM. Aktualisht ajo është eksperte shkencore për një Komision ad hoc të Këshillit të Evropës për hartimin e një konvente për dhunën kundër gruas dhe dhunën në familje. Ajo ka qenë anëtare e Misionit për gjetjen e fakteve për Beit Hanoun, në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara S 3/1, maj 2008, dhe Misionin e KB-së për gjetjen e fakteve në Konfliktin e Gazës në vitin 2009

2.2. Staf i Sekretariatit

16. Sekretariati i Panelit përbëhet prej një zyrtari ekzekutiv, dy zyrtarëve ligjorë dhe dy asistenteve administrative. Më poshtë në tekst janë dhënë informatat biografike të anëtarëve të Sekretariatit që kanë punuar gjatë vitit 2011.

2.2.1. Anëtarët e Sekretariatit në fund të vitit 2011

17. **Andrey Antonov**, shtetas i Rusisë, ka filluar punën në Sekretariat në qershor 2011 si zyrtar ekzekutiv. Paraprakisht, z. Antonov ka punuar si hetues në Divizionin e Hetimeve në Zyrën për Kontroll të Brendshëm në KB (UN HQ) (2011), si zyrtar për sjellje dhe disiplinë në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudan (2009-2011), si zyrtar ligjor në Zyrën e Integruar të Kombeve të Bashkuara në Sierra Leone (2008-2009), si zyrtar ligjor në Division Kriminal të Departamentit të Drejtësisë (DD) në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) (2005-2008), dhe si zyrtar ligjor në Sektorin për Integritet Gjyqësor në DD të UNMIK-ut (2003-2005). Para se të filloj punën në Kombet e Bashkuara, z. Antonov punoi në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Rusisë (MPB), në pozitën e hetuesit penal (Departamenti policor i transportit, Anapa, 1999) dhe ka pasur postin e ligjëruesit/ligjëruesit të lartë për lëndën Procedura penale dhe hetimi penal (Universiteti Krasnodar, MPB të Rusisë, 1999-2003). Në Kosovë për herë të parë arriti në vitin 2000 si pjesëtar i kontingjentit rus, i dërguar nga MPB të Rusisë për të shërbyer në Policinë e UNMIK-ut, ku ai punoi si zyrtar ligjor në Zyrën ligjore të Komisionerit të Policisë së UNMIK-ut deri në vitin 2002. Që nga viti 1999, z. Antonov ka doktoruar për drejtësi (PhD), i specializuar për procedurën penale, hetimin penal dhe detektimin e krimit, në Akademinë Volgograd për drejtësi në MPB të Rusisë, dhe që nga viti 1996 ka magjistruar për drejtësi (LLM) në fushën e njëjtë ligjore, në vitin 1996 në Akademinë Volgograd për drejtësi në MPB të Rusisë. Përveç këtyre, ai është autor i më shumë se 20 publikimeve në botimet periodike të specializuara të Rusisë që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të hetimeve penale.

18. **Anna Maria Cesano**, Anna Maria Cesano, shtetase e Italisë, filloi punën në Sekretariat në maj të vitit 2011 si specialiste për të drejtat e njeriut, e dërguar nga UNDP-ja dhe me financim të siguruar nga Qeveria suedeze. Paraprakisht, znj. Cesano punoi si zyrtare për sundimin e së drejtës në Programin për qasje në drejtësi të Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara në Sierra Leone (2010-2011), si zyrtare për ndërlidhje për Komisionerin e Lartë për Refugjatë të Kombeve të Bashkuara në Tanzani (2009) dhe si zyrtare për të drejtat e njeriut në Zyrën e integruar të Kombeve të Bashkuara në Sierra Leone (2007-2009). Para fillimit të punës në Kombet e Bashkuara, znj. Cesano punoi në Universitetin Siena, Itali (2006-2007) si kërkuese e sistemit evropian për mbrojtjen e të

drejtave të njeriut. Znj. Cesano për herë të parë filloi punën në Ballkan në vitin 2005 në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Serbi dhe Mal të Zi. Ajo ka magjistruar për të drejtat e njeriut dhe menaxhimin e konflikteve në Universitetin Sant' Anna, studime të avancuara të Pisa, dhe ka magjistruar për drejtësi në Univeristetin Katolik në Milano, Itali.

19. **Brandon Gardner**, shtetas amerikan dhe ish anëtar i Odës së avokatëve të Pensilvanisë, filloi punën në Sekretariat në postin e zyrtarit ligjor në tetor 2011. Paraprakisht, z. Gardner ka punuar si këshilltar ligjor në Komisionin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa, në emër të Misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, të vendosur në Kosovë (2009-2011). Para kësaj, z. Gardner ka punuar si zyrtar ligjor në Sektorin për marrëdhënie me jashtë në Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut dhe në Zyrën ndërlidhëse të UNMIK-ut për sundimin e së drejtës (2007-2009). Z. Gardner ka punuar edhe si avokat në Pensilvani (2006-2007). Z. Gardner ka doktoruar në drejtësi në Fakultetin e drejtësisë në Universitetin e Pitsburgut, dhe ka diplomuar në shkencat politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare në Universitetin e Pitsburgut.

20. **Snežana Martinović**, është punonjëse vendore, e cila punon si asistente administrative në Sekretariat që nga dhjetori 2007. Ajo ia filloi punën në Kombet e Bashkuara në vitin 2000, ku ka punuar si asistente administrative në Departamentin e Drejtësisë të UNMIK-ut.

21. **Adlije Muzaqi**, është punonjëse vendore, e cila punon si asistente administrative në Sekretariat që nga shtatori 2010. Ajo ia filloi punën në Kombet e Bashkuara në tetor të vitit 1999 si asistente administrative në Administratën komunale të UNMIK-ut në komunën e Vushtrrisë, rajoni i Mitrovicës.

2.2.2. Anëtarët e Sekretarisë që kanë shërbyer gjatë vitit 2011

22. **Rajesh Talwar**, shtetas indian, i cili ka punuar për Kombet e Bashkuara gjatë dhjetë viteve të kaluar në cilësi të ndryshme në Kosovë, Somali, Liberi dhe Afganistan para se të kthehet në Kosovë për të marrë postin e Zyrtarit ekzekutiv në Sekretarinë e Panelit për të Drejtat e Njeriut. Para se të punojë për Kombet e Bashkuara ai ka punuar në Gjykatën Supreme të Indisë dhe gjykatat vartëse të saj. Derisa ai po punonte si avokat, njëkohësisht mbante ligjërata për studentët e drejtësisë (LLB) në Universitetin Delhi dhe Jamia Millia Islamia për gjashtë vite. Si avokat ai ishte ngushtë i lidhur me disa raste të të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe peticionet e rëndësishme që kanë të bëjnë me çështjet që dalin nga HIV/AIDS. Në vitin 1996 ai shkoi në MB me bursën Britaneze Chevening, me të cilën ai magjistroi (LLM) për Ligjin mbi të drejtat e njeriut në Universitetin e Notinghamit. Ai është autor i disa publikimeve, duke përfshirë edhe libra për drejtësi dhe të drejtat e njeriut. Në shkurt të vitit 2011, z. Talwar e la punën në Sekretariat për të filluar punën në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Timorin Lindor si këshilltar ligjor për Komisionerin e Policisë.

23. **Anila Premti**, shtetase e Shqipërisë, ia filloi punën në Sekretari si zyrtare ligjore në tetor të vitit 2010, e caktuar për një angazhim të përkohshëm nga pozita e saj e rregullt në UNCTAD në Gjenevë, Zvicër, ku ajo ka punuar që nga viti 2004. Më përpara, znj. Premti ka shërbyer po ashtu si zyrtare ligjore në Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut, në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të

Mirëbesimit (2007-2009), dhe në Zyrën e Kombeve të Bashkuara për çështje ligjore, Divizioni për kodifikim, në Nju Jork (2001-2004). Para se të filloj punën në Kombet e Bashkuara, znj. Premti ka punuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Shqipëri (1995-2001), ku ajo është përqendruar në çështjet ligjore dhe ato të traktateve, si dhe në çështje të të drejtave të njeriut në kontekstin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe në Këshillin e Evropës. Znj. Premti ka magjistruar në drejtësi në Universitetin Tulane në Shtetet e Bashkuara, dhe ka diplomuar në Universitetin e Tiranës, Shqipëri. Ajo ka studiuar edhe të drejtën ndërkombëtare dhe marrëdhëniet ndërkombëtare në Holandë dhe në Mbretërinë e Bashkuar. Në tetor të vitit 2011, znj. Premti u kthye në postin e saj të rregullt në UNCTAD.

24. **Ravi K. Reddy**, shtetas amerikan dhe anëtar i Odës së Avokatëve të Nju Jorkut, iu bashkua Sekretarisë si zyrtar ligjor në maj të vitit 2009. Më parë z. Reddy ka shërbyer si zyrtar ligjor në zyrën e drejtorit të Departamentit të drejtësisë të UNMIK-ut dhe si zyrtar ligjor në Programin e Shteteve të Bashkuara për avokim të Human Rights Watch. Z. Reddy ka kryer magjistraturën në fushën e të drejtave të njeriut në Universitetin e Notinghamit, ka doktoruar në Universitetin e Pitsburgut dhe ka diplomuar në arte dhe histori në Universitetin e Delaveres. Në qershor 2011, z. Reddy ia filloi punën në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Timorin Lindor, ku mban postin e zyrtarit ligjor në Zyrën e këshilltarit ligjor.

3. Korniza rregullative

3.1. Rregullorja nr. 2006/12 dhe Urdhëresa administrative nr. 2009/1

25. Korniza kryesore ligjore për punën e Panelit mbetet Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/13, përmes së cilës Panelit i jepen autorizimet për shqyrtimin e ankesave me diapazon të gjerë lidhur me shkeljen e drejtave të njeriut që pretendohet se janë bërë nga UNMIK-u duke u bazuar në instrumentet vijuese: Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve të tjera Jonjerëzore dhe Poshtëruese dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Juridiksioni kohor i Panelit fillon nga 23 prilli 2005.⁴

26. Më 17 tetor 2009, PSSP-ja ka shpallur Urdhëresën administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut. Përmes kësaj Urdhërese administrative ndryshohen kriteret për pranueshmëri, procedura për shqyrtimin e ankesave, mënyra e mbajtjes së seancave publike dhe procedura e emërimit për anëtarët e Panelit. Përmes kësaj Rregulloreje gjithashtu rregullohet mënyra e botimit të komunikatave për shtyp dhe e shpalljeve të Panelit. Kjo urdhëresë gjithashtu parasheh datën e fundit për paraqitjen e ankesave pranë Panelit. Kjo Urdhëresë administrative është diskutuar gjerë e gjatë në raportin e Panelit të vitit 2009 në §§ 35-45.

⁴ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, Neni 2.

27. Procedura e Panelit përbëhet prej dy fazave kryesore⁵: e para ka të bëjë me shqyrtimin e pranueshmërisë, ndërsa faza e dytë me rastin e shpalljes së ankesës si të pranueshme dhe me shqyrtimin e bazueshmërisë së saj. Pranueshmëria përcaktohet përmes një vendimi formal, ku ceket edhe arsyetimi i tij. Në disa raste, Paneli fillimisht ka marrë vendim të pjesshëm për pranueshmërinë, dhe më pastaj në vendimin e formës së prerë janë përcaktuar çështjet e mbetura të pranueshmërisë. Vendimet publikohen në faqen e internetit të Panelit pasi të jenë njoftuar palët në procedurë. Nëse Paneli shpall si të pranueshme tërë ankesën apo pjesë të caktuara të saj, pastaj fillon me shqyrtimin e bazueshmërisë së ankesës.

28. Nëse shqyrtimi i ankesës vazhdon me shqyrtimin e bazueshmërisë së saj, Paneli paraqet mendimin e tij nëse ankuesit i janë shkelur të drejtat e njeriut, e që i atribuohen UNMIK-ut, dhe që mund të ketë rekomandime drejtuar PSSP-së⁶. Pasi t'u jetë dhënë mendimi palëve, të njëjtit gjithashtu publikohen në faqen e internetit të Panelit⁷. Nga ky moment, vetëm PSSP-ja ka autorizim për të vepruar apo jo në bazë të gjetjeve të Panelit.⁸

4. Uebsajti i Panelit

29. Uebsajti i Panelit⁹ është avancuar edhe më shumë në vitin 2011 për të mundësuar bashkëveprim më të mirë të përdoruesit dhe qasje më të lehtë në vendimet dhe mendimet e Panelit. Në uebsajt janë shënuar vendimet dhe mendimet e Panelit në dy formate të ndryshme. Në uebsajt vazhdon shënimi i lëndëve sipas emrit të ankuesit, ashtu që çdokush të ketë qasje të shpejtë në vendimet dhe mendimet për ndonjë rast të caktuar. Përveç kësaj, Paneli po ashtu shënon çdo vendim dhe mendim të tij sipas numrit të lëndës, ashtu që opinioni publik të mund të përcjellë zhvillimin e praktikës gjyqësore të Panelit. Në uebsajt janë duke u shtuar edhe gjëra të tjera për të përmirësuar qasjen e shfrytëzuesit.

5. Numri i lëndëve në Panel dhe të dhënat statistikore

5.1. Të dhënat statistikore

30. Gjatë periudhës raportuese, nuk janë pranuar ankesa të reja, meqë 31 marsi 2010 ishte data e fundit për paraqitjen e ankesave të reja. Ndërmjet 2006 dhe 2010, Paneli ka pranuar gjithsej 526 ankesa¹⁰. Në fund të vitit 2011, të gjitha ankesat janë përkthyer.

31. Gjatë periudhës raportuese, Paneli miratoi 6 mendime për bazueshmërinë (lidhur me 46 ankesa), konstatoi se 114 ankesa janë të papranueshme ose pjesërisht të pranueshme, shpalli 50 ankesa të papranueshme dhe 2 ankesa i largoi nga lista.

⁵ Për përshkrime të mëtejshme të procedurës pranë Panelit, shih Raportin vjetor të Panelit të vitit 2009, i cili gjendet në: http://www.unmikonline.org/human_rights/documents/annual_report_2009.pdf 48-60.

⁶ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, neni 17.1.

⁷ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, neni 17.2.

⁸ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, neni 17.3.

⁹ <http://www.unmikonline.org/hrap/Eng/Pages/default.aspx>

¹⁰ Ky numër ndryshon pak nga raportet paraprake meqë ankesat e pranuar janë ndarë për arsye teknike.

32. Në fund të vitit 2011, ishin 257 lëndë në pritje pranë Panelit në fazën e pranueshmërisë, dhe 105 lëndë në pritje për mendim mbi bazueshmërinë ¹¹. Paneli mbylli 98 lëndë në vitin 2011.

33. Gjatë vitit 2011, Paneli vendosi për pranueshmërinë e 72 ankesave që kishin të bënin me pohimet se UNMIK-u nuk kishte hetuar në mënyrën e duhur një rast të vrasjes apo të një personi të zhdukur që lidhet me konfliktin në Kosovë, duke shpallur të pranueshme 71 të këtyre vendimeve. Paneli aktualisht është duke përgatitur nxjerrjen e mendimeve të tij për bazueshmërinë e kësaj kategorie të lëndëve, që pritet të kryhen gjatë vitit 2012.

¹¹ Në lëndët për të cilat ka mendim të pjesshëm për bazueshmërinë, lënda akoma pret mendimin përfundimtar për bazueshmërinë. Gjithashtu, pas shpalljes së Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1, disa lëndë që presin mendimin për bazueshmërinë për ato kërkohet edhe një vendim i dytë për pranueshmërinë.

Numri i lëndëve, komunikatave & vendimeve të HRAP-it Prej 31 dhjetor 2011								
Numri i lëndëve	2006	2007	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	
Të pranuar	3	12	69	353 ¹²	89	n/a	526	
Të mbyllura	0	0	18	11	37	98	164	
Në pritje të zgjidhjes	3	15	66	407	459	362	362	
Komunikata	2006	2007	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	
Të komunikuar PSSP-së	0 ¹³	0	30	71	60	117	278	
Përgjigje nga PSSP-ja	0	0	18	75	30	100	223	
Në pritje të përgjigjes nga PSSP-ja	0	0	12	8	38	55	55	
Vendimet: Lloji	2006	2007	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	
Gjithsej	0	0	32	23	78	213	346	
Vendimet për pranueshmëri	0	0	28	22	56	164	270	
Vendimet për pranueshmëri të pjesshme	0	0	2	0	1	0	3	
Të hequr nga lista	0	0	0	3	5	2	10	
Mendimet për bazueshmëri	0	0	1	0	22	46	69	
Mendime për bazueshmëri të pjesshme	0	0	0	1 ¹⁴	0	0	1	
Kërkesat për rishqyrtim	0	0	1	0	0	1	2	
Vendimet: Gjetjet	2006	2007	2008	2009	2010	2011	Gjithsej	
Vendimet	Të pranueshme	0	0	11	2	16	63	92
	Pjesërisht të pranueshme	0	0	(2)	9	24(1)	51	84(3¹⁵)
	Të papranueshme	0	0	17	8	10	50	85
	Të hequr nga lista	0	0	0	3	5	2	10
Mendimet: Shkelje	0	0	1	0	21	45	67	
Mendimet: Nuk ka shkelje	0	0	0	(1)	1	1	2 (1¹⁶)	
Kërkesat për rishqyrtim	0	0	1	0	0	1	2	

¹² Lëndët e pranuar në vitin 2009 dhe të ndara në dy apo më shumë lëndë në vitin 2010 u janë shtuar shifrave të vitit 2009.

¹³ Paneli nuk është emëruar deri në janar 2007 dhe nuk e ka mbajtur seancën e tij të parë deri në nëntor 2007, prandaj ka vetëm 0 në të gjitha kolonat në vitin 2006 dhe 2007, me përjashtim të rasteve të pranuar dhe rasteve në pritje për zgjidhje.

¹⁴ Kjo i referohet një mendimi të pjesshëm për bazueshmërinë, në të cilin Paneli vendosi një çështje të rëndësishme substanciale, por pezulloi shqyrtimin e mëtejshëm të bazueshmërisë për një datë të mëvonshme; shih raportin vjetor të vitit 2009, §§ 75 dhe 94.

¹⁵ Numrat në kllapa u referohen vendimeve të pjesshme për pranueshmëri.

¹⁶ Numrat në kllapa u referohen mendimeve të pjesshme për bazueshmëri të cilëve iu referuam në fusnotën 14, lart.

5.2. Tendencat në numrin e përgjithshëm të lëndëve dhe çështjet tjera të rëndësishme

34. Disa tendenca në numrin e përgjithshëm të lëndëve dhe punës së Panelit kanë mbetur të njëjta, ndërsa të tjerat kanë ndryshuar dukshëm nga periudha e fundit raportuese. Në vitin 2011, Paneli e caktoi prioritet të parë miratimin e vendimeve për pranueshmëri për një numër sa më të madh të rasteve të pohimeve për hetime të paefektshme për persona të zhdukur dhe/ose të vrarë (PZHV). Meqë këto raste janë jashtëzakonisht të ndjeshme dhe mbledhja e informacioneve shpesh ishte një detyrë sfiduese, Paneli paraqiti metodologji të reja në grumbullimin e të dhënave për lëndët e tilla. Kjo përfshinte shfrytëzimin gjithnjë e më të madh të bazave të ndryshme të të dhënave që përmbanin materiale relevante, siç janë bazat e të dhënave të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, të Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur, dhe Zyrën e UNMIK-ut/EULEX-it për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore. Paneli ishte i mendimit se kur ekzistonte supozimi që kur një person i afërt i ankuesit ishte i shënuar në ndonjërin prej këtyre bazave të të dhënave si PZHV, UNMIK-u ka pasur informacione të mjaftueshme për zhdukjen dhe/ose vrasjen e PZHV, dhe prandaj e kishte për obligim që të hetojë vrasjen dhe/ose zhdukjen sipas kushteve procedurale për të drejtën për jetë (neni 2 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)).

35. Lidhur me këto raste, Paneli ka pranuar një numër të konsiderueshëm të dosjeve nga Policia e UNMIK-ut dhe dosje të tjera lidhur me hetimet e rasteve të vrasjeve dhe personave të zhdukur. Kjo i mundësoi Panelit të bënte analiza më të thella të fakteve dhe rrethanave lidhur me këto çështje të ndjeshme. Mirëpo, siç u përmend lart, qasja në këto dosje, shumica e të cilave aktualisht janë në posedim të Misionit të EULEX-it në Kosovë, nuk varet gjithmonë vetëm nga përpjekjet e UNMIK-ut, dhe për një numër të rasteve ka pasur vonesa të mëdha ndërmjet periudhës kur Paneli ka kërkuar informacionet e tilla dhe kohën kur ato janë siguruar, nëse janë siguruar. Edhe pse bashkëpunimi ndërmjet UNMIK-ut, EULEX-it dhe Panelit është përmirësuar disi lidhur me këto çështje, vonesa në kohë për UNMIK-un që të procedojë me kërkesat e tilla ka ndikuar tek Paneli që të vazhdojë punën tutje në këto lëndë.

36. Një trend tjetër që Paneli e ka vërejtur lidhur me rastet e PZHV-ve gjatë vitit 2011 ishte ai që UNMIK-u filloi të kundërshtojë pranueshmërinë e të drejtës së ankuesit që të mos trajtohet në mënyrë johumane, veçanërisht të drejtën për të mos pësuar dhimbje dhe vuajtje mentale të shkaktuar nga zhdukja e një të afërmi (neni 3 i KEDNJ). Në rastet e mëparshme, UNMIK-u nuk e ka kundërshtuar pranueshmërinë e nenit 3 në këtë kontekst. Mirëpo, kah fundi i periudhës raportuese, UNMIK-u ofroi një numër argumentesh me të cilët kundërshtojë pranueshmëria e nenit 3 lidhur me obligimet e UNMIK-ut. Këto zhvillime janë diskutuar më detajisht më poshtë (§ 55 dhe si vijon.)

37. Paneli vazhdoi me nxjerrjen e vendimeve dhe mendimeve ku përfshiheshin disa çështje, veçanërisht për “14,000” lëndët¹⁷, ku faktet ishin mjaftueshëm të ngjashëm për të mundësuar

¹⁷ U referohemi mijëra lëndëve të parashtruara kundër UNMIK-ut, KFOR-it, dhe IPVQ-ve, dhe komunave të ndryshme në vitin 2004, për të cilat lëndë është pezulluar procedura pas një shkresë të dërguar nga UNMIK-u gjykatave të ndryshme në Kosovë. Në kohën kur është dërguar shkresa, i referohej “mbi 14,000 lëndëve” të paraqitura. Në fund, shifra ishte afër 17,000 – 18,000 lëndë.

kategorizime të tilla. Kjo metodë i lejoi Panelit të punojë në mënyrë më ekspeditive në këto çështje.

38. Në vitin 2011, Paneli dhe Sekretariati shfrytëzuan më shumë resurset tjera për grumbullimin e informacioneve të cilat nuk mund t'i merrte nga parashtrirat e ankuesve të paraqitura pranë Panelit. Për shembull, Zyrat ndërlidhëse të gjykatës në Ministrinë e Drejtësisë shumë herë Panelit i kanë siguruar informacione tepër të çmueshme që deri tani kanë qenë të paarrtshme. Gjithashtu, Prokurori Publik e Qarkut në Prishtinë i ka dorëzuar Panelit materiale sipas kërkesave. Ngjashëm, Policia e UNMIK-ut i ka siguruar Panelit informacione lidhur me ankesat, dhe ka vepruar si kanal komunikimi i kërkesave për informacione ndërmjet Panelit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë. Sekretariati u takua me asociacione të ndryshme lidhur me familjet e personave të cilët ishin vlarë ose zhdukur gjatë konfliktit në Kosovë. Sekretariati gjithashtu vizitoi një ankues dhe mbajti shumë takime në zyrë me ankues për grumbullimin e informacioneve relevante. Për të përshpejtuar procedimin e disa rasteve, Sekretariati bëri disa vizita në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, për të marrë dokumentacione, duke përfshirë edhe dosje të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe aktgjykime të Dhomës së Posaçme të cilat nuk ishin siguruar nga ankuesit. Në fakt, aq shumë materiale u grumbulluan përmes kësaj metode sa që Paneli kishte mundësi të kategorizonte këto lëndë për marrjen e vendimeve mbi pranueshmërinë e tyre, për të filluar procedimin e tyre në vitin 2012.

39. Përveç rasteve të sipërpërmendura, Paneli vazhdoi me procedimin e rasteve lidhur me sa vijon:

- Pohimet për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (neni 6 § 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), e drejta për respektim të jetës private dhe familjare (neni 8 § 1 i KEDNJ), e drejta për mbrojtje të pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ), si dhe e drejta për mjet të efektshëm (neni 13 i KEDNJ), lidhur me vendimet e nxjerra nga Drejtoria për çështje banesore pronësore dhe nga Komisioni i tij për ankesa banesore pronësore, dhe Agjencia Kosovare e Pronës dhe Komisioni i saj për ankesa lidhur me pronësinë dhe zotërimin e pronës.
- Pohimet për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (neni 6 § 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), e drejta për respektim të jetës private dhe familjare (neni 8 § 1 i KEDNJ), e drejta për mbrojtje të pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ), si dhe e drejta për mjet të efektshëm (neni 13 i KEDNJ), lidhur me dëbimet e pasuksesshme të uzurpuesve, siç pohohej të paligjshëm të pronave.
- Pohimet për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (neni 6 § 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), e drejta për respektim të jetës private dhe familjare (neni 8 § 1 i KEDNJ), e drejta për mbrojtje të pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ), si dhe e drejta për mjet të efektshëm (neni 13 i KEDNJ), lidhur me siç pohohej vendimet konfliktuoze për rastet pronësore ndërmjet Drejtorisë për çështje banesore pronësore apo Agjencisë Kosovare të Pronës dhe gjykatave komunale dhe atyre të qarkut.

- Pohimet për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (neni 6 § 1 i KEDNJ) dhe e drejta për mbrojtje të pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ), lidhur me vendimet e nxjerra nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, që kanë të bëjnë me përfitimet e punëtorëve që është dashur t'u paguhen përmes privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore (NSH) si dhe pronësia e NSH-ve.

5.3. Mendimet dhe vendimet e Panelit sipas lëndës për shqyrtim

40. Më poshtë janë shënuar disa raste sipas lëndës për shqyrtim:

E drejta për jetë – E drejta për hetime të efektshme – Ndalimi i torturës dhe trajtimit jonjerëzor apo degradues

Mungesa e hetimeve të efektshme nga ana e UNMIK lidhur me rastet e vrasjeve

- *M.M. dhe V.M.*, 35/09 (vendim i 18 marsit 2011) – I pranueshëm
- *N.P., D.P., D.K., B.P., L.J., D.L., & S.P.*, 341/09 (vendim i 15 shtatorit 2011) – I papranueshëm

Mungesa e hetimeve të efektshme nga ana e UNMIK për rastet e vrasjeve/personave të zhdukur lidhur me konfliktim

- *C.S.*, 45/09 (vendim i 18 marsit 2011) – I pranueshëm
- *Rada Gjukanoviç dhe Radmila Gjukanoviç*, 67/09 & 140/09 (vendim i 18 marsit 2011) – I pranueshëm
- *Ljiljana Shljiviç-Çeraniç*, 237/09 & 238/09 (vendim i 18 marsit 2011) – I pranueshëm
- *S.P. dhe Vidosava Gjorgjeviç*, 06/09 & 55/09 (vendim i 13 prillit 2011) – I pranueshëm
- *Mileva Stanishiç*, 49/09 (vendim i 13 prillit 2011) – I pranueshëm
- *Svetlana Joçiç*, 34/09 (vendim i 13 prillit 2011) - I pranueshëm
- *Nadica Nedeljkoviç*, 46/09 (vendim i 13 prillit 2011) - I pranueshëm
- *Stana Paviç*, 47/09 (vendim i 13 prillit 2011) - I pranueshëm
- *Ruhan Ruhani*, 85/09 (vendim i 13 prillit 2011) - I pranueshëm GJ.L. 88/09 (vendim i 13 prillit 2011) - I pranueshëm
- *Svetlana Marinkoviç*, 94/09 (vendim i 13 prillit 2011) – I pranueshëm
- *Ljiljana Milenkoviç*, 97/09, *Marica Stojanoviç*, 332/09, *Dalibor Milenkoviç*, 335/09 & *Ljubisha Milenkoviç*, 345/09 (vendim i 13 prillit 2011) - I pranueshëm
- *Dushan Tomanoviç*, 248/09, *Jelena Tomanoviç-Kokotoviç*, 250/09 & *Verica Tomanoviç*, 251/09 (vendim i 13 prillit 2011) - I pranueshëm
- *Slavica Nedeljkoviç*, 268/09 (vendimi 13 prillit 2011) – I pranueshëm
- *Zvezdan Vitosheviç*, 116/09 (vendim i 12 majit 2011) – I pranueshëm
- *Ivan Vujaçiç*, 118/09 (vendim i 12 majit 2011) – I pranueshëm S.C., 13/09, V.F., 93/09 & O.L., 302/09 (vendim i 11 gushtit 2011) – I pranueshëm
- *Katica Gjurica*, 79/09 (vendim i 12 gushtit 2011) – I pranueshëm

- *Nenad Stojković*, 87/09 (vendim i 11 gushtit 2011) – I pranueshëm *Olivera Vitosheviç*, 90/09 & *Arsenije Vitosheviç*, 103/09 (vendim i 12 gushtit 2011) - I pranueshëm
- *Marija Filipoviç*, 92/09 (vendim i 11 gushtit 2011) - I pranueshëm *Jordanka Paviç*, 98/09 (vendim i 12 gushtit 2011) - I pranueshëm
- *Milica Mladenoviç*, 99/09 (vendim i 11 gushtit 2011) – I pranueshëm
- *Slavica Ristanoviç*, 123/09 (vendim i 12 gushtit 2011) – I pranueshëm
- *Zorka Ristiç*, 132/09 (vendim i 11 gushtit 2011) – I pranueshëm
- *Zvonko Shabiç*, 137/09 (vendim i 12 gushtit 2011) – I pranueshëm
- *Angelina Bishevac*, 223/09 (vendim i 12 gushtit 2011) – I pranueshëm
- *Milivoje Todorovski*, 81/09 (vendim i 16 shtatorit 2011) – I pranueshëm
- *Danica Stanojkoviç*, 105/09 & *Milosav Stojkoviç*, 106/09 (vendim i 15 shtatorit 2011) – I pranueshëm
- *Tatjana Vitosheviç*, 139/09, *Veska Majmareviç*, 218/09 & *Natasha Majmareviç*, 325/09 (vendim i 15 shtatorit 2011) – I pranueshëm
- *Goran Knezheviç*, 141/09 (vendim i 15 shtatorit 2011) – I pranueshëm
- *Dobrija Antiç-Zhivkoviç*, 147/09 (vendim i 15 shtatorit 2011) – I pranueshëm
- *Vuksan Bulatoviç*, 166/09 (vendim i 15 shtatorit 2011) – I pranueshëm
- *Bosiljka Radovanoviç*, 177/09 (vendim i 16 shtatorit 2011) – I pranueshëm
- *Verica Niçetiç*, 69/09 (vendim i 27 tetorit 2011) – I pranueshëm
- *Milan Petroviç*, 95/09 & 96/09 (vendim i 27 tetorit 2011) – I pranueshëm
- *Ljubica Buljeviç*, 146/09 (vendim i 27 tetorit 2011) – I pranueshëm
- *Jagoda Vukiçeviç*, 272/09 (vendim i 22 tetorit 2011) – I pranueshëm
- *Velibor Agjançiç* 43/09, *Olga Agjançiç*, 54/09, *M.A.*, 114/09, *Ljiljana Vukmiroviç*, 173/09 & *Bozhidarka Buha*, 242/09 (vendim i 26 nëntorit 2011) – I pranueshëm
- *Tomislav Steviç*, 50/09 (vendim i 26 nëntorit 2011) – I pranueshëm
- *D.I.*, 57/09 (vendim i 26 nëntorit 2011) – I pranueshëm
- *Milorad Pejçinoviç*, 89/09 (vendim i 7 nëntorit 2011) – I pranueshëm
- *Milijana Miniç*, 101/09 & 107/09 (vendim i 8 nëntorit 2011) – I pranueshëm
- *Mirjana Bogiçeviç*, 112/09 (vendim i 26 nëntorit 2011) – I pranueshëm
- *Biljana Radovanoviç*, 154/09 & 155/09 (vendim i 26 nëntorit 2011) – I pranueshëm
- *Vinogorka Jovanoviç*, 222/09 (vendim i 26 nëntorit 2011) – I pranueshëm
- *Slobodan Petkoviç*, 133/09 (vendim i 16 dhjetorit 2011) – I pranueshëm
- *Cica Jankoviç*, 249/09 (vendim i 16 dhjetorit 2011) – I pranueshëm
- *Verica Patrnogiç*, 252/09 (vendim i 16 dhjetorit 2011) – I pranueshëm
- *Mira Ozhegoviç*, 267/09 (vendim i 16 dhjetorit 2011) – I pranueshëm
- *Vladimir Shçepanoviç*, 271/09 (vendim i 16 dhjetorit 2011) – I pranueshëm
- *Vuksan Bulatoviç*, 165/09 (vendim i 21 dhjetorit 2011) – I pranueshëm

Prona - E drejta për posedim të papenguar

Ankesa kundër Gjyqësorit të Serbisë

- *Todor Veselinoviç*, 65/10 (vendim i 16 dhjetorit 2011) - I papranueshëm
- Dështimi i UNMIK-ut në mbrojtjen e pronës private

- *Olga Patrnoçiç*, 294/09 (vendim i 12 majit 2011) – I papranueshëm
- *Miodrag Jankoviç*, 62/10 (vendim i 26 tetorit 2011) - I papranueshëm

Uzarpimi i pronës nga NATO

- *Slavica Grubiç-Milutinoviç*, 21/10 (vendim i 26 nëntorit 2011) - I papranueshëm

Ankesa kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit

- *Branko Andriç*, 64/10 (vendim i 16 dhjetorit 2011) - I papranueshëm

Ankesa kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme pas 9 dhjetorit 2008

- *Feti Islami*, 13/10 (vendim i 16 shtatorit 2011) – I papranueshëm

Kontestet për kontrata – E drejta për qasje në gjykatë

Shkelja e kontratës nga Trupat Mbrojtëse të Kosovës

- *NTP Bujari (AS Petrol)*, 311/09 (vendim i 18 marsit 2011) – I pranueshëm
- *Linda, LLC*, 45/08 (vendim i 13 majit 2011) - I pranueshëm

Kontestet e punësimit

E drejta për punë

- *Milos Sejat dhe të Tjerët (“Elektrokosmet”)*, 33/10, *Tomislav Miliçeviç dhe të Tjerët (“Sindikati JPPK Kosovo Obilić”)*, 34/10 & *Radojko Gajiç dhe të Tjerët (“JP Termoelektrane Obilić”)*, 35/10 (vendim i 17 marsit 2011) - I papranueshëm

Shkarkim nga Trupat Mbrojtëse të Kosovës

- *Gani Thaçi*, 13/08 (vendim i 10 qershorit 2011) - I pranueshëm

Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

- *N.G.*, 45/10 (vendim i 13 prillit 2011) - I papranueshëm

Rastet e Komisionit të Ankesave për Çështje Banesore Pronësore

E drejta për gjykim të drejtë – E drejta për mjet efektiv – E drejta për posedim të papenguar të pronës – E drejta për marrjen e një vendimi brenda një periudhe kohore të arsyeshme

- *Slavko Vuliç*, 05/07 (vendim i 18 marsit 2011) – Nuk ka shkelje
- *Dragan Gjorgjeviç*, 03/09 (vendim i 12 gushtit 2011) - I papranueshëm

“14,000” lëndët

E drejta për gjykim të drejtë — E drejta për posedim të papenguar – E drejta për mjet efektiv

- *Ruzha Simiç*, 316/09 (vendim i 21 janarit 2011) - I pranueshëm
- *Momir Krasniç*, 299/09 (vendim i 21 janarit 2011) - I pranueshëm
- *Danica Laliç*, 30/08, *Slobodan Dragojeviç*, 66/08, *Sreten Camoviç*, 24/09, *Milijazim Krasniç*, 25/09, *Petar Bojiç*, 26/09, *Bajram Rama*, 28/09, *Boshko Antiç*, 33/09, *Dragoslav Mladenoviç*, 115/09, *Luka Angjelkoviç*, 183/09, *Draginja Vujaçiç*, 186/09, *Plana Foliç*, 198/09, *Jefka Ljakiç*, 305/09 & *Malina Agjançiç*, 350/09 (vendim i 23 shkurtit 2011) - I pranueshëm

Esat Berisha, 27/08, *Milka Zhivkoviç*, 29/08, *M.R.*, 42/08, *ZH.S.*, 44/08, *Tomo Petroviç*, 59/08, *Obrad Gjoshoviç*, 60/08, *Dragan Petkoviç*, 64/08, *Miodrag Milosavljeviç*, 67/08,

Çedo Raleviç, 07/09, Miljko Raleviç, 08/09, Dragomir Raleviç, 09/09, Milenko Raleviç, 10/09, Simo Raleviç, 11/09, Muharem Ibraj, 16/09 & 17/09, Musa Ibraj, 22/09 & Slobodan Açimoviç, 32/09 (mendim i 23 shkurtit 2011) – Shkelje

- *Danica Laliç, 30/08, Slobodan Dragojeviç, 66/08, Sreten Camoviç, 24/09, Milijazim Krasniçi, 25/09, Petar Bojiç, 26/09, Bajram Rama, 28/09, Boshko Antiç, 33/09, Dragoslav Mladenoviç, 115/09, Luka Angjerkoviç, 183/09, Draginja Vujaçiç, 186/09, Plana Foliç, 198/09, Jefka Ljakiç, 305/09, Ruzha Simiç, 316/09, & Malina Agjançiç, 350/09 (mendim i 13 majit 2011) – Shkelje*
- *R.V., 16/10 & 17/10 (vendim i 9 qershorit 2011) - I pranueshëm*
- *Nenad Mladenoviç, 172/09, Lidija Milenkoviç, 182/09, Bogoljub Kostić, 190/09, Blagica Niçiç, 207/09, Sadik Nuka, 315/09, Miodrag Malishiç, 317 & 318/09, Zhivorad Radiç, 321/09, Nebojsa Miladinovic, 331/09 & Vuksan Bulatoviç, 353/09 (vendim i 15 shtatorit 2011) – I pranueshëm*
- *Nenad Mladenoviç, 172/09, Lidija Milenkoviç, 182/09, Bogoljub Kostić, 190/09, Blagica Niçiç, 207/09, Momir Krasiciç, 299/09 Sadik Nuka, 315/09, Miodrag Malishiç, 317 & 318/09, Zhivorad Radiç, 321/09, Vuksan Bulatoviç, 353/09 & R.V., 16/10 & 17/10 (mendim i 16 dhjetorit 2011) – Shkelje*
- *Dragan Piljeviç, 05/09 (vendim i 16 dhjetorit 2011) - I pranueshëm*
- *Velibor Agjançiç, 310/09 (vendim i 16 dhjetorit 2011) - I pranueshëm*

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit

E drejta për gjykim të drejtë – E drejta për posedim të papenguar të pronës - E drejta për mjet efektiv — E drejta për marrjen e një vendimi gjyqësor brenda një periudhe kohore të arsyeshme – E drejta për seancë dëgjimore nga një tribunal i paanshëm i themeluar sipas ligjit

- *Rodoljub Todoroviç, 33/08 (mendim i 15 prillit 2011) – Shkelje*
- *Kabash Krasniçi, 20/08 (mendim i 13 majit 2011) – Shkelje*
- *Agjencia për Sigurimin e Depozitave, 59/10 (vendim i 26 tetorit 2011) – I papranueshëm*
- *Jovica Joksimoviç, 37/10 (vendim i 26 nëntorit 2011) – I papranueshëm*

E drejta për të mos u diskriminuar

- *Fillim Guga, 47/08 (vendim i 9 qershorit 2011) – I pranueshëm*

Të drejtat e personave me aftësi të kufizuar

- *N.G., 45/10 (vendim i 13 prillit 2011) - I papranueshëm*

6. Praktika gjyqësore e Panelit

41. Meqë viti 2011 ishte viti i parë që Paneli nuk pranonte më ankesa, Paneli pati mundësi të arrijë progres të konsiderueshëm në trajtimin e lëndëve të pazgjidhura. Ajo çka është edhe më e rëndësishme, me mbylljen e 98 lëndëve që ishin në listën e çështjeve gjyqësore, Paneli nxori vendime dhe mendime me të cilët ankuesve u bëri me dije se është arritur një shkallë e caktuar progresi në përmbjlljen e lëndëve, përderisa njëkohësisht zgjeronte praktikën e tij gjyqësore dhe iu referohej një sërë praktikash të reja dhe çështje substanciale. Disa vendime

dhe mendime të rëndësishme që Paneli i ka marrë në vitin 2011 janë përshkruar detajisht më poshtë.

6.1. Çështjet e pranueshmërisë

Rregulla për periudhën gjashtëmuajore

42. Kur një ankesë parashtrohet në Zyrën e UNMIK-ut në Beograd, e cila për rrjedhojë vonohet shumë derisa të arrijë pranë Panelit, ecja e periudhës gjashtëmuajore gjatë së cilës ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë Panelit pezullohet nga koha kur ankesa dorëzohet në Zyrën e UNMIK-ut në Beograd. Shih HRAP, *Gjorgjeviç*, nr. 03/09, vendim i 12 gushtit 2011.

43. Kur është bërë hetim zyrtar dhe më pas ndërpritet me njoftim ligjor mbi ndërprerjen e hetimeve, periudha gjashtëmuajore gjatë së cilës ankuesi mund të parashtrojë ankesë pranë Panelit fillon të ecë nga dita e pranimit të njoftimit të tillë. Shih HRAP, *N.P., D.P., D.K., B.P., L.J., D.L., & S.P.*, nr. 341/09, vendim i 15 shtatorit 2011.

44. Kur Gjykata Supreme nxjerr vendim me të cilin kërkesën e aplikuesit e deklaron të papranueshme për mungesë kompetencash, ky vendim konsiderohet vendim i formës së prerë për qëllimet e ecjes së afatit kohor prej gjashtë muajsh për paraqitjen e ankesës pranë Panelit. Shih HRAP, *Thaçi*, nr. 13/08, vendim i 10 qershorit 2011.

45. Kur ankuesi i merr mbetjet mortore të një personi të vvarë, periudha gjashtëmuajore fillon të ecë nga ajo datë. Shih HRAP, *Petkoviç*, nr. 133/09, vendim i 16 dhjetorit 2011.

Juridiksioni kohor (*Ratione Temporis*)

46. Kur kemi rast të largimit të një punëtori nga vendi i tij i punës, data e largimit e përcakton nëse Paneli ka kompetenca kohore (*ratione temporis*) për të trajtuar ankesën. Në rastin *Sejat dhe të Tjerët ("Elektrokosmet")*, ankuesit argumentuan se largimi i 6,559 individëve nga vendi i tyre i punës gjatë verës së vitit 1999, pa njoftim apo dokumentacion, i ka privuar ata nga mundësia që të marrin pjesë në procedura që lidheshin me punësim, ashtu siç parashihet me ligjin në fuqi. Mirëpo, sipas nenit 2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, Paneli ka kompetenca të shqyrtojë vetëm shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut që janë bërë jo më herët se 23 prill 2005, apo që dalin nga fakte që janë paraqitur para asaj date kur faktet e tilla dëshmojnë shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut. Pra, meqë largimet nga puna u bënë më 1999, dhe meqë largimet si të tilla konsiderohen "akte të atypëratyshme", Paneli nuk kishte kompetenca kohore (*ratione temporis*) për shqyrtimin e ankesës. Shih HRAP, *Sejat dhe të Tjerët ("Elektrokosmet")*, lënda nr. 33/10, vendim i 17 marsit 2011.

47. Kur personi i zhdukur më vonë gjendet i vdekur, zbatimi i nenit 3 të KEDNJ në parim është i kufizuar për periudhën e caktuar gjatë së cilës anëtar(i) e familjes kanë qenë në gjendje pasigurie, ankthi dhe shqetësimi për shkak të fenomenit specifik të zhdukjeve. Në rastin *Stojkoviç*, ankuesi pretendonte se kishte pasur dhimbje dhe vuajtje mentale për të cilat e ngarkonte UNMIK-un për shkak të gjendjes së zhdukjes së vëllait të tij dhe më vonë edhe të

vrasjes së tij. Në vitin 1999 vëllai i ankuesi u zhduk. Mbetjet e tij u gjetën në vitin 2000, dhe iu kthyen familjes së ankuesit në gusht të vitit 2003. Paneli fillimisht theksoi se sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, anëtari i familjes së personit të zhdukur nën rrethana të caktuara mund të konsiderohet viktimë e një trajtimi nga autoritetet në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ, që ndalon trajtimin johuman. Paneli theksoi se derisa nuk kishte fare dyshime sa u përket vuajtjeve të thella që ankuesit i ishin shkaktuar nga zhdukja dhe vdekja e vëllait të tij, megjithatë konkludoi se ankesa lidhur me shkeljen e nenit 3 të KEDNJ ishte jashtë kompetencave të tij kohore (*ratione temporis*). Shih HRAP, *Stojkoviç*, nr. 87/09, vendi i 11 gushtit 2011. Për shqyrtim të mëtejshëm të nenit 3 të KEDNJ, shih § 55 dhe si vijon, më poshtë.

Juridiksioni *Ratione Personae*

48. Edhe pse lidhet me konceptin e kompetencës *ratione temporis* të Panelit, Paneli konsideron se në raste të caktuara lidhur me ngjarjet që ndodhën pasi UNMIK-u pushoi ushtrimin e pushtetit ekzekutiv në një fushë të caktuar, Paneli nuk kishte juridiksion *ratione personae* për akterët të cilët ishin përgjegjës për aktet e dyshuara. Në rastin *N.G.*, Paneli ripohoi qëndrimin tij të mëparshëm që mori parasysh realitetin politik në terren dhe se konstatoi që nga 15 qershori 2008 e tutje, “UNMIK-u në parim nuk mund të mbahej përgjegjës për veprimet apo mosveprimet për të cilët fajësoheshin autoritetet e Kosovës, thjesht mbi bazën e vazhimit të ekzistimit të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 (1999).” Paneli vazhdoi të mbajë qëndrimin se pavarësisht çka u tha më lart, mund të ketë rrethana të veçanta që mund të shpien në ndonjë konkludim tjetër në raste të caktuara. Shih HRAP, *N.G.*, nr. 45/10, vendim i 13 prillit 2011.

49. Në rastin *N.G.*, ankuesi u ankua se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale kishte shkelur të drejtat e tij si person me aftësi të kufizuara, duke marrë vendim me të cilin iu mohua vazhdimi i marrjes së pensionit invalidor. Pas shqyrtimit të kompetencave të tij *ratione personae* për të trajtuar ankesën, Paneli sërish theksoi se, pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës më 15 qershor 2008, dhe duk marrë parasysh raportet e shumta të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara lidhur me këtë çështje, PSSP-ja nuk pati sukses të zbatojë në tërësi pushtetin e tij ekzekutiv, me të cilin ai formalisht akoma është i veshur sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 (1999). Paneli shpjegoi se çështja për të cilën është parashtruar ankesë nuk përfshinte përgjegjësinë e UNMIK-ut. Shih HRAP, *N.G.*, cituar lart (§ 48).

50. Ngjashëm, në rastin *Islami*, Paneli konsideron se kur vendimi në fjalë ishte marrë nga Gjykata Supreme në vitin 2009, UNMIK-u më nuk ushtronte pushtet ekzekutiv mbi gjyqësorin e Kosovës dhe nuk kishte përgjegjësi për ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut siç pretendohet se është kryer nga ata. Prandaj, pohimet e tilla ishin jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit. Shih HRAP, *Islami*, nr. 13/10, vendim i 16 shtatorit 2011. Paneli përdori arsyetimin e njëjtë në rastin *Joksimoviç*, ku vendimi në fjalë ishte marrë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, në qershor 2011, që sërish ishte jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit. Shih HRAP, *Joksimoviç*, nr. 37/10, vendim i 26 nëntorit 2011. Për çështjet që lidhen me AKP dhe DÇBP, Paneli ripohoi se periudha e shqyrtimit përfundoi më 31 dhjetor 2008, kur skadoi

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/50 me të cilën u themelua AKP-ja si pasardhëse e DÇBP (HPD). Shih HRAP, *Vuliç*, nr. 05/07, mendim i 18 marsit 2011.

51. Rasti *Veselinoviç* ngriti një aspekt tjetër të kompetencës *ratione personae* të Panelit. Ankesa kishte të bënte me pohime për sjellje të papërshtatshme të autoriteteve gjyqësore të Republikës së Serbisë. Meqë Paneli konstatoi se kjo çështje në asnjë mënyrë nuk përfshinte përgjegjësinë e UNMIK-ut, ankesa ishte jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit. Shih HRAP, *Veselinoviç*, nr. 65/10, vendim i 16 dhjetorit 2011. Në mënyrë të ngjashme, në rastin e *Agjencisë për Sigurimin e Depozitave*, ku ankuesi ishte agjenci publike e regjistruar sipas ligjeve të Republikës së Serbisë, Paneli konstatoi se Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12 nuk mund të interpretohet ashtu që të përfshijë ankesat e paraqitura nga ndonjë shtet apo agjenci e tij, dhe si e tillë ankesa ishte jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit. Shih HRAP, *Agjencia për Sigurimin e Depozitave*, nr. 59/10, vendim i 26 tetorit 2011.

52. Përfundimisht, në rastin *Grubiç-Milutinoviç*, Paneli konstatoi se një ankesë kundër NATO-s ishte po ashtu jashtë juridiksionit të tij *ratione personae*. Shih HRAP, *Grubiç-Milutinoviç*, nr. 21/10, vendim i 26 nëntorit 2011.

Çështje të tjera të pranueshmërisë – Zotësia e ankuesit

53. Në rastin *NTP Bujari (AS Petrol)*, Paneli duhej të përcaktonte nëse një kompani komerciale konsiderohet “person” për qëllimet e interpretimit të nenit 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12. PSSP-ja argumentoi se ankuesi ishte person juridik dhe se nuk kishte zotësi për të parashtruar ankesë. Paneli nuk u pajtua dhe theksoi se fjala “person” përgjithësisht mund të kuptohet se përfshin jo vetëm personat fizikë por edhe personat juridikë. Prandaj, ankuesi kishte të drejtë të paraqesë ankesë. Shih HRAP, *NTP Bujari (AS Petrol)*, nr. 311/09, vendim i 18 marsit 2011. Shih gjithashtu HRAP, *Linda, LLC*, nr. 45/08, vendim i 13 majit 2011.

6.2. Heqja e rasteve nga lista

54. Përveç rasteve ku ankuesit më nuk dëshironin të ndjekin procedurën e mëtejshme të ankesës (Shih për shembull HRAP, *Vezire Shenari dhe Sevdije Shenari*, nr. 54/08 vendim i 23 shkurtit 2011), Paneli po ashtu hoqi nga lista një rast që ishte thjesht përsëritje e një ankese të paraqitur më parë. Shih gjithashtu HRAP, *N.G.*, cituar lart (§ 48).

6.3. Çështjet substanciale

6.3.1. E drejta për t’u mbrojtur nga trajtimi johuman apo degradues – Neni 3 i KEDNJ

55. Në vitin 2011, Paneli rikonfirmoi qëndrimin e tij, që më përpara nuk ishte kundërshtuar nga UNMIK-u për një numër të madh të vendimeve për pranueshmërinë e ankesave, se një ankues mund të pretendojë se UNMIK-u është përgjegjës për vuajtjet dhe dhimbjet mentale që u janë shkaktuar atyre dhe familjeve me zhdukjen e një pjesëtari të familjes në territorin e Kosovës në kohën e konfliktit apo rreth asaj kohe në Kosovë. Shih HRAP, *Vujaçi*, nr. 118/09, vendim i 12 majit 2011. Por duke filluar me rastin *Gjurica*, UNMIK-u rregullisht filloi të kontestojë zbatimin e nenit 3 të KEDNJ për këtë kategori të rasteve. Në rastin *Gjurica*, djali i ankuesit ishte thirrur rekrut në Ushtrinë jugosllave dhe u zhduk më 13 qershor 1999, derisa ishte në detyrë afër Prishtinës. UNMIK-u argumentoi se ankuesi nuk paraqiti fakte që do të mund të dëshmonin shkeljen e nenit 3 të KEDNJ. Paneli mendoi ndryshe, duke thënë se përkundër mungesës së pohimeve të shprehura nga ana e ankuesit në këtë aspekt, ankuesi prezantoi fakte relevante në të cilat mund të bazohet pohimi për shkelje të nenit 3 të KEDNJ. Paneli e bazoi arsyetimin tij në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila pajtohet se shkelje e nenit 3 mund të bëhet, varësisht nga ekzistimi i “faktorëve specialë që vuajtjeve të pjesëtarit të familjes i japin një dimension dhe karakter ndryshe nga shqetësimi emocional, që mund të konsiderohet se pashmangshëm u është shkaktuar të afërmit të viktimës nga një shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut”. Paneli vazhdoi me citimin e Gjykatës Evropiane, duke thënë se “elementët relevantë do të përfshijnë afërsinë e lidhjeve familjare, rrethanat e caktuara të marrëdhënies, deri në ç’masë pjesëtari i familjes ka dëshmuar për ngjarjet në fjalë, përfshirjen e pjesëtarit të familjes në përpjekje të marrjes së informacioneve për zhdukjen e personit, dhe mënyrën se si autoritetet u janë përgjigjur këtyre pyetjeve”. Paneli arsyetoi se Gjykata Evropiane gjithashtu thekson “se esenca e një shkelje të tillë nuk varet aq shumë në faktin e zhdukjes së pjesëtarit të familjes por në reagimin dhe qëndrimin e autoriteteve ndaj situatës së tillë kur ata njoftohen për rastin”. Shih HRAP, *Gjurica*, nr. 79/09, vendim i 12 gushtit 2011.

56. UNMIK-u vazhdoi të mos pajtohet me Panelin për zbatimin e nenit 3 për një numër të rasteve. Një rast i tillë ishte *Filipoviç*, ku faktet për të ishin si vijon: ankuesja pohonte se bashkëshorti i saj ishte vrarë në Prizren më 21 qershor 1999. Edhe pse vendi i krimit ishte rrethuar nga KFOR-i gjerman pas ngjarjes, dhe trupi pohohet se është varrosur në praninë e trupave të KFOR-it dy ditë pas vrasjes së tij, siç duket trupi i tij ishte vendosur gabimisht dhe u rizbulua gati 8 vite më vonë nga Zyra e UNMIK-ut për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore në Prizren. UNMIK-u argumenton se neni 3 nuk u zbatua për shkak se ankuesja nuk pohoi shprehimisht se vuajtjet mentale dhe ankthi që ajo i kishte pasur ishin rezultat i reagimit të UNMIK-ut ndaj vrasjes së bashkëshortit të saj. Paneli vendosi se neni 3 nuk u zbatua në këtë rast por për arsye të tjera. Paneli theksoi se Gjykata Evropiane zakonisht nuk e zgjeron zbatimin e nenit 3 të KEDNJ për të afërmit e personit i cili është vrarë në rastin e një vdekje të atypëratyshme. Paneli zbatoi parimet e njëjta për të konkluduar se në këtë rast neni 3 nuk mund të zbatohet. Shih HRAP, *Filipoviç*, nr. 92/09, vendim i 11 gushtit 2011.

57. Në një rast tjetër, *Mladenoviç*, për të cilin është marrë vendim të njëjtën ditë sikurse edhe për *Filipoviç*, Paneli shtjelloi të gjeturat lidhur me zbatimin e nenit 3 në një situatë tjetër faktike. Ankuesja në rastin *Mladenoviç* pohoi se djali i saj ishte kidnapuar në Kosovë

më 25 qershor 1999. Përkundër faktit se e kishte raportuar zhdukjen e djalit të saj në UNMIK, si dhe në shumë organizata të tjera, djali i saj akoma është i zhdukur. UNMIK-u sërish argumentoi se neni 3 i KEDNJ nuk mund të zbatohet, meqë ankuesja nuk pohoi shprehimisht se frika dhe ankthi që ajo kishte pasur ishin pasojë e reagimit të UNMIK-ut për zhdukjen e djalit të ankueses. Paneli nuk u pajtua, dhe konsideron se një ankues mund të thirret në shkelje të nenit 3 të KEDNJ edhe nëse nuk ka referencë eksplicite ndaj akteve specifike të autoriteteve të përfshira në hetime, meqë edhe pasiviteti i autoriteteve dhe mungesa e informacioneve për ankuesin mund të jenë indikacion për trajtim johuman të ankuesit nga autoritetet. Paneli konkludoi se kjo pjesë e ankesës nuk ishte e pabazuar në shikim të parë; Paneli kundërshtoi vërejtjet e UNMIK-ut dhe ankesën për nenin 3 e shpalli të pranueshme. Shih HRAP, *Mladenović*, nr. 99/09, vendim i 11 gushtit 2011.

6.3.2. E drejta për gjykim të drejtë – neni 6 § 1 i KEDNJ

E drejta për qasje në gjykatë

58. Të drejtat e garantuara në nenin 6 § 1 të KEDNJ, d.m.th. e drejta e ankuesve që ankesat e tyre të vendosen nga gjykatat, nuk ndikohen nga mosveprimet e ankuesve pasi ankesa të jetë parashtruar pranë gjykatës relevante. Shih HRAP, *Laliç dhe të Tjerët*, nr. 30/08, 66/08, 24/09, 25/09, 26/09, 28/09, 33/09, 115/09, 183/09, 186/09, 198/09, 305/09, 316/09 dhe 350/09, mendim i 13 majit 2011.

59. Në rastin *Laliç dhe të Tjerët*, ankuesit pohuan se shkresa e gushtit 2004 e cekur lart, nga Departamenti i drejtësisë së UNMIK-ut, që ndaloi procedurën për një grup të caktuar të lëndëve të paraqitur në numër të madh nga grupi etnik i serbëve të zhvendosur për dëme të shkaktuara pasurisë së tyre pas hyrjes së UNMIK-ut në Kosovë në vitin 1999, dhe që më vonë njihen si “14,000 lëndët”, rezultuan me shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ në aspekte të ndryshme. UNMIK-u paraqiti një numër argumentesh, shumicën e të cilave Paneli tanimë i kishte refuzuar në rastet *Milogoriç dhe të Tjerët* dhe *Berisha dhe të Tjerët*. (Shih HRAP, *Milogoriç, dhe të Tjerët*, nr. 38/08, 58/08, 61/08, 63/08 dhe 69/08, mendim i 24 marsit 2010 dhe HRAP, *Berisha dhe të Tjerët*, nr. 27/08, 29/08, 42/08, 44/08, 59/08, 60/08, 64/08, 67/08, 07/09, 08/09, 09/09, 10/09, 11/09, 16/09 & 17/09, 22/09 dhe 32/09, mendim i 23 shkurtit 2011). Mirëpo, UNMIK-u gjithashtu argumentoi se shumica e ankuesve nuk kishin paraqitur asnjë dëshmi për të treguar se ata ndonjëherë janë interesuar të pyesin se deri ku kanë arritur rastet e tyre, as nuk janë ankuar që rastet e tyre duhet të trajtohen në gjykatat vendore në Kosovë, nga DD apo nga ndonjë organ tjetër i UNMIK-ut apo IPVQ-ve, duke përfshirë edhe zyrat ndërlidhëse të gjykatave. Ankuesit as nuk ishin ankuar në EULEX pas vendosjes së këtij misioni në Kosovë në dhjetor 2008. UNMIK-u po ashtu argumentoi se disa nga ankuesit nuk kishin dëshmuar se kanë ndërmarrë hapa për të rimarrë posedimin mbi pronën e tyre, pas vendimeve të nxjerra nga Komisioni i ankesave për çështje banesore pronësore (HPCC) ndërmjet qershorit 2003 dhe tetorit 2008.

60. Këto argumente Paneli nuk i konsideroi bindëse. Së pari, sa i përket pohimit për mosinteresimin e ankuesve që të kërkojnë informacione në gjykatat relevante për progresin e bërë në rastet e tyre, Paneli theksoi se pasi që ankuesit i kishin parashtruar ankesat e tyre, ata me arsye kanë pritur që të caktohet një datë për seancë dëgjimore. Ata nuk kanë qenë të

obliguar të ndërmarrin hapa të mëtejshëm. Për më tepër, pezullimi i shqyrtimit të rasteve të tyre nuk ishte për shkak të funksionimit të gjykatave relevante por ishte pasojë e një shkresë të përgjithshme, dërguar gjykatave nga Drejtori i DD. Në këto rrethana, kërkimi i informacioneve në gjykatën relevante për të mësuar mbi gjendjen e procedurës për cilindo rast, nuk do të kishte efekt për progresin aktual të atij rasti. Prandaj, Paneli është i mendimit se ankuesit nuk mund të fajësohen për mos-kërkimin e informacioneve lidhur me progresin e rasteve të tyre. Sa i përket argumentit se ankuesit nuk kërkuan informacione as në EULEX për progresin e rasteve të tyre, pas vendosjes së EULEX-it në dhjetor 2008, Paneli konstatoi se kjo çështje ishte relevante për shqyrtimin e ankesave, meqë ankesat lidhen me një situatë që zgjati deri në shtator 2008. Për më tepër, situata pas dhjetori 2008 sido që të jetë ishte jashtë përgjegjësisë të UNMIK-ut. Përfundimisht, për derisa UNMIK-u argumentoi se disa nga ankuesit nuk dëshmuuan se ndërmorën hapa për të rimarrë në posedim pronën e tyre pas një vendimi të marrë në favore të tyre nga Komisioni i ankesave për çështje banesore pronësore (HPCC), ndërmjet qershorit 2003 dhe tetorit 2008, për këtë argument Paneli gjithashtu konstatoi se është irelevant. Kërkesat e ankuesve drejtuar HPCC-së kishin të bënin me njohjen e të drejtave të tyre pronësore, kurse kërkesat drejtuar gjykatave kishin të bënin me kompensimin e dëmit shkaktuar pronës së tyre. Këto dy lloje të kërkesave janë të ndryshme për nga natyra. Vendimet e marra nga HPCC nuk mund të kishin lidhje me procedimin e kërkesave për kompensim nga gjykatat. Duke marrë parasysh këto konstatime, Paneli vendosi se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ për shkak se ankuesit nuk kanë pasur mundësinë që kërkesat e tyre të vendosen nga gjykatat. Shih HRAP, *Laliç dhe të Tjerët*, cituar lart (§ 58).

Tribunali i pavarur dhe i paanshëm i themeluar sipas ligjit

61. Në rastin *Krasniçi* nga Paneli kërkohet të vendosë nëse Dhoma e Posaçme kishte vepruar si tribunal i paanshëm i themeluar sipas ligjit, duke u bazuar në faktin se aktgjykimi kundër ankuesit ishte kaluar nga një panel i përbërë prej katër gjyqtarësh, kurse legjislacioni përkatës parashihte që paneli të jetë i përbërë prej pesë gjyqtarësh. Së pari Paneli iu referua nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13, por nuk e konsideroi këtë nen përcaktues për këtë çështje. Pastaj Paneli shqyrtoi nenin 13.3 të Urdhresës administrative të UNMIK-ut nr. 2006/17, të cilin Paneli e konsideroi më të qartë. Fjalja e parë e nenit 13.3 parasheh “penele të përbërë prej tre gjyqtarësh”, jo minimumi prej tre. Ky formulim strikt është vërtetuar me faktin se fjalia e dytë vazhdon duke specifikuar se “paneli i tillë prej tre gjyqtarësh” përbëhet nga gjyqtari kryesues i Dhomës së Posaçme apo të emëruarit të tij, nga një gjyqtar ndërkombëtar, dhe nga një gjyqtar i cili është banor i Kosovës. Në të nuk parashihet përbërja e panelit prej katër gjyqtarësh. Shih HRAP, *Krasniçi*, nr. 20/08, mendim i 13 majit 2011.

62. Paneli erdhi tek konkludimi se një rast i paraqitur pranë Dhomës së Posaçme mund të dëgjohet nga Dhoma në përbërje të plotë, e përbërë nga pesë gjyqtarë, ose nga një panel prej tre gjyqtarësh duke reflektuar përbërjen e përzier të Dhomës së Posaçme (shumica e gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe pakica a gjyqtarëve vendorë), por jo nga një panel i përbërë prej katër gjyqtarësh. Nëse rasti do t'i caktohej një paneli prej tre gjyqtarësh, vendimet do të duhej të miratoheshin me konsensus; nëse njëri prej gjyqtarëve nuk mund t'u bashkohet dy kolegëve të tij, rasti do të duhej referuar Dhomës në përbërje të plotë prej pesë gjyqtarësh.

Mund të ketë situata ku Dhoma në përbërje të plotë prej pesë gjyqtarësh nuk ka mundësi të mblihet. Do të ishte plotësisht e kuptueshme nëse korniza rregullative në fuqi do t'i mundësonte gjyqtarit kryesues të devijonte nga rregullat e përgjithshme në fuqi dhe rastet e caktuara t'ua referonte panelit prej katër gjyqtarësh. Mirëpo, në kornizën ligjore nuk kishte asgjë që në mënyrë eksplicite e lejonte gjyqtarin kryesues ta bëjë një gjë të tillë. Edhe po të supozojmë se gjyqtari kryesues do të ishte i autorizuar në mënyrë të nënkuptuar që të gjente zgjidhje të atypëratyshme (*ad hoc*) në rastet ku është e nevojshme, ligji nuk përcaktonte asnjë kriter lidhur me këtë. Paqartësia ligjore që pason dhe mungesa e transparencës janë në vetvete jokompatibile me kushtin që një tribunal duhet të jetë “i themeluar me ligj”, d.m.th. që përbërja e tij duhet të definohet sipas rregullave të qarta, ashtu që të mund të shmanget paraqitja e arbitraritetit në caktimin e rasteve specifike gjyqtarëve të caktuar. Në përputhje me këtë, Paneli konstatoi se Dhoma e Posaçme e mbledhur për rastin e ankuesit me katër gjyqtarë nuk mund të konsiderohej tribunal i themeluar sipas ligjit, dhe për këtë arsye konstatoi se neni 6 § 1 i KEDNJ ishte shkelur. Shih HRAP, *Krasniçi*, cituar lart (§ 61).

Drejtësia e Procedurës

63. Rregulla e përgjithshme është se gjykatat kompetente duhet të vlerësojnë dëshmitë që u janë prezentuar si dhe rëndësinë e dëshmimeve të cilën palët kërkojnë ta sjellin. Paneli ndërhyr vetëm kur vlerësimi i dëshmimeve apo konstatimi i fakteve nga gjykata vihet në dyshim në bazë të asaj se në shikim të parë kanë qenë të paarsyeshme apo në ndonjë mënyrë tjetër kanë qenë arbitrare. Paneli nuk zëvendëson vlerësimin e tij të fakteve me atë të tribunalit apo gjykatës relevante. Detyra e Panelit është të konstatojë nëse kanë qenë të drejta procedurat në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e vlerësimit të dëshmimeve. Shih HRAP, *Guga*, nr. 47/08, vendim i 9 qershorit 2011.

Kohëzgjatja e procedurës

64. Në rastet civile, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet vlerësuar duke marrë parasysh rrethanat e rastit dhe duke iu referuar kritereve vijuese: kompleksiteti i rastit, sjellja e ankuesit dhe e autoriteteve relevante, dhe në çfarë aspekti është rrezikuar ankuesi në kontestin në fjalë. Është detyrë e autoriteteve relevante të organizojnë sistemin e tyre ligjor ashtu që gjykatave t'u mundësojnë t'i plotësojnë kushtet e nenit 6 § 1 të KEDNJ, duke përfshirë edhe të drejtën për një vendim gjyqësor brenda “një kohe të arsyeshme”. Shih HRAP, *Todoroviç*, nr. 33/08, mendim i 15 prillit 2011.

65. Në rastin *Todoroviç*, ankuesi ishte trashëgimtar i një parcele toke në Prizren e cila ishte shpronësuar nga autoritetet relevante në vitin 1965, dhe dorëzuar një ndërmarrje në pronësi shoqërore. Në vitin 1998, ankuesit morën një vendim nga Ministria e Financave të Serbisë në të cilin thuhej se vendimi për shpronësim më nuk ishte valid. Mirëpo, për shkak të konfliktit, ankuesi nuk pati mundësi të rimerr pronën e tij. Më 10 janar 2005, ankuesi parashtrroi kërkesë në Dhomën e Posaçme duke kërkuar kompensim monetar për tokën e cila do të privatizohej. Më 23 tetor 2007, Dhoma e Posaçme miratoi aktgjykimin e saj kundër ankuesit, dhe në korrik 2008, ankuesit iu dorëzua aktgjykimi i formës së prerë. Duke marrë parasysh kohëzgjatjen e procedurës, Paneli theksoi se kërkesa e parashtruar nga kërkuesi dhe nga bashkë-kërkuesit e tij pranë Dhomës së Posaçme ngritën çështje

komplekse ligjore; mirëpo, kompleksiteti i rastit nuk e arsyetoi periudhën prej 3.5 vjet për përfundimin e procedurës ose periudhën prej 8.5 muaj për përpilimin dhe dorëzimin e aktgjykimit.

66. Paneli konstatoi se përderisa ankuesit kanë mundur t'i kontribuojnë pak vonesës me paraqitjen e parashtrësave shtesë pas përfundimit të seancave dëgjimore, vonesa në përgatitjen e aktgjykimit me shkrim dhe vonesa në dorëzimin e saj natyrisht se nuk mund t'i atribuohen ankuesit. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, PSSP-ja argumentoi se për nxjerrjen e aktgjykimit nevojitej kohë më e gjatë sepse gjyqtari raportues ishte ngarkuar me një sërë detyrash administrative. Sipas mendimit të Panelit, ky nuk ishte argument bindës, meqë neni 6 § 1 i KEDNJ u imponon autoriteteve kompetente detyrën të organizojnë sistemin e tyre gjyqësor në mënyrë të tillë që gjykatat të kenë mundësi të përmbushin secilin kusht të asaj dispozite, duke përfshirë edhe detyrimin e caktimit të rasteve brenda një kohe të arsyeshme. Në vend se gjyqtarit t'i caktojnë detyra administrative, autoritetet kanë mundur ta lirojnë atë nga këto detyra, që atij t'i mundësojnë të përpilojë tekstin e aktgjykimit. PSSP-ja po ashtu argumentoi se vonesat në dorëzimin e aktgjykimit të formës së prerë ishin shkaktuar nga shqyrtimi i draft tekstit të aktgjykimit, mungesat e vazhdueshme të gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe nevojën e përkthimit të drafteve dhe ndryshimeve. Paneli pranon se miratimi i një aktgjykimi nga një gjykatë pjesërisht e përbërë nga gjyqtarë ndërkombëtarë dhe pjesërisht nga gjyqtarë kosovarë mund të kërkojë më shumë kohë sesa kur gjykata përbëhet ekskluzivisht nga gjyqtarë kosovarë, ku të gjithë e flasin gjuhën e njëjtë. Mirëpo, PSSP-ja nuk ka dhënë ndonjë përshkrim të detajuar të efekteve të pranisë së gjyqtarëve ndërkombëtarë në kohëzgjatjen e shqyrtimeve për këtë rast, as nuk ka përmendur ndonjë rrethanë specifike që do ta kishte vështirësuar dorëzimin e aktgjykimit ankuesit apo përfaqësuesit të tij. Prandaj, Paneli vendosi që, kryesisht si pasojë e vonesës në përpilimin e aktgjykimit me shkrim dhe më vonë dërgimit të tij, ankuesi nuk ka marrë vendim brenda një kohe të arsyeshme: prandaj ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ. Shih HRAP *Todoroviç*, cituar lart (§ 64); krahaso me *Vuliç*, cituar lart (§ 67).

Ekzekutimi i vendimeve

67. Në rastin *Vuliç*, ankuesi argumentoi se Komisioni i ankesave për çështje banesore pronësore (HPCC), si organ për zgjidhjen e kontesteve lidhur me ankesat e paraqitura në numër të madh, që lidhen me të drejta pronësore banesore, shkeli të drejtën e tij për gjykim të drejtë në pajtim me nenin 6 § 1 të KEDNJ, veçanërisht duke ia mohuar atij të drejtën në zbatimin e vendimit të formës së prerë. Faktet relevante janë përmbledhur si vijon: pasuria a paluajtshme e ankuesit në komunën e Klinës u uzurpua pas shpërthimit të luftës në Kosovë në vitin 1999. Në vitin 2002, ankuesi parashtrroi kërkesë pranë DÇBP (HPD) duke kërkuar riposedimin e pronës së tij. Më 16 nëntor 2006, HPCC-ja miratoi vendimin e saj për rishqyrtim në favor të ankuesit. U bënë më shumë se dy vite dhe shtatë muaj para se vendimi të zbatohet me sukses dhe ankuesit t'i kthehet posedimi i pronës së tij. Mirëpo, Paneli theksoi se ankuesi, në një shkallë të caktuar, i kontribuoi vonesës duke mos i marrë çelësat e pronës së tij dhe duke mos zbatuar procedurat standarde për veprim të AKP-së. Në këtë aspekt,

Paneli iu referua nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60, e cila parasheh që “çdo person i cili pa arsyetim të ligjshëm, hyn në pronën e tjetrit duke e thyer plumbin, mund të largohet nga prona nga autoritetet për zbatimin e ligjit”. Kjo dispozitë është interpretuar nga AKP se ka pasur detyrim të ekzekutojë një dëbim tjetër vetëm nëse prona do të uzurpohej sërish brenda 72 orëve nga dëbimi i parë. Kështu që, ankuesi në fakt, e ka vënë veten e tij në një situatë të çuditshme duke e përkeqësuar gjendjen e tij me mosmarrjen e çelësave për pronën e tij. Po t’i kishte marrë ai çelësat e kësaj prone qoftë pas dy dëbimeve të pohuara të suksesshme dhe të kishte raportuar se prona sërish ishte uzurpuar më pas, atëherë AKP-ja do të kishte qenë e obliguar të ekzekutonte edhe një largim tjetër. Por, ankuesi nuk i mori çelësat, duke ia kaluar kështu detyrimin policisë të bëjë cilindo dëbim. Mirëpo, policia tha se ishte AKP-ja ajo e cila duhej të ndërmerre veprime pas marrjes së kërkesës për dëbim, meqë policia nuk kishte kompetenca të veprojë për çështje pronësore, përveç nëse prona ishte uzurpuar sërish, dhe në rastin aktual që prona të mos konsiderohej asnjëherë se ka qenë në pronësi të ankuesit. Prandaj, ankuesi në thelb e ka vënë veten në situatë ku as AKP as policia nuk ishin përgjegjëse për ekzekutimin e një dëbimi tjetër. Paneli theksoi se vetëm një vit e 15 ditë nga kohëzgjatja e përgjithshme e procesit të zbatimit përfshiheshin brenda periudhës kur UNMIK-u administronte me AKP-në, dhe se vetëm kjo periudhë është në kompetencë të Panelit. Sa i përket kësaj periudhe kohore, Paneli konsideroi, veçanërisht duke marrë parasysh sjelljen e ankuesit, se kjo vonesë nuk rezultoi (së paku jo deri më 31 dhjetor 2008) në mohimin e të drejtës së ankuesit për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë dhe detyrues. Prandaj, Paneli konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ. Shih HRAP, *Vuliç*, nr. 05/07, mendimi 18 marsit 2011.

7. Rekomandimet e Panelit

68. Në vitin 2011, Paneli miratoi një numër të mendimeve për bazueshmërinë ku konstatoi shkelje të të drejtave të njeriut për të cilat UNMIK-u ishte përgjegjës. Një vështirësi në vazhdimësi ishte çështja se çfarë rekomandimesh të bënte në një situatë ku UNMIK-u më nuk ka mundësi të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në vendimet që merren në Kosovë. Siç u tha më parë, UNMIK-u më nuk mund të ndryshojë legjislacionin kur është e nevojshme (apo sido që të jetë, edhe nëse ndryshon legjislacionin relevant, nuk mund të sigurojë zbatimin), as nuk mund të urdhërojë autoritetet e Kosovës të korrigjojnë të meta të tjera të identifikuar nga Paneli. Kjo gjendje e detyron Panelin të jetë i vetëdijshëm për kufizimet e tilla derisa bën rekomandime që do të kenë ndikim përfitues në situatën e të drejtave të njeriut të ankuesve që janë të ndikuar nga situata e tillë.

69. Në disa raste, Paneli rekomandoi kompensim jo-monetar për shkeljen (shih HRAP, *Mladenoviç dhe të Tjerët nr. 172/09, 182/09, 190/09, 207/09, 299/09, 315/09, 317/09, 318/09, 321/09, 353/09, 16/10 dhe 17/10, mendim i 16 dhjetorit 2011*). Në raste të tjera, Paneli rekomandoi që vetë UNMIK të pranonte se kishte ndodhur shkelje, dhe tha se ky pranim do të rregullonte mjaftueshëm rrethanat. Shih HRAP, *Krasniçi*, cituar lart (§ 61).

70. Në raste të tjera akoma, Paneli do të kishte rekomanduar UNMIK-un të ndërmerre veprime të caktuara konkrete për rregullimin e situatës, po të mos ekzistonte fakti se UNMIK-u nuk është më në gjendje të ushtrojë mandatin e tij sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244, pas shpalljes së njëanshme të deklaratës së pavarësisë nga

autoritetet e Kosovës dhe zhvillimeve të mëpastajme në terren. Duke ditur faktin se vetë UNMIK-u nuk mund të merrte hapat e nevojshëm për rregullimin e një situate, Paneli i ka rekomanduar UNMIK-ut të ndajë mendimin me aktorët relevant në fushën përkatëse për të shtyrë ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme. Paneli e ka përdorur këtë formulë në rastin *Laliç dhe të Tjerët*, duke i rekomanduar UNMIK-ut të “nxisin autoritetet kosovare të ndërmarrin të gjitha hapat e mundshëm për të siguruar që lëndët e ankuesve të zgjidhen pa vonesë” Shih HRAP, *Laliç dhe të Tjerët*, cituar lart (§ 68).

71. Në çdo ankesë që është paraqitur deri më sot, ku Paneli ka konstatuar shkelje, Paneli ka rekomanduar që UNMIK-u të ndërmerr masa të menjëhershme dhe efektive për implementimin e rekomandimeve të tij, dhe të njoftojë ankuesin dhe Panelin për zhvillimet e mëtejshme për rastin. Mirëpo, mungesa e informacioneve të UNMIK-ut për implementimin e rekomandimeve të Panelit po bëhet një brengë gjithnjë e më e madhe.

8. Mosreagimi publik i UNMIK-ut ndaj rekomandimeve të Panelit

72. Pas miratimit të një mendimi për bazueshmërinë, Paneli ia komunikon atë mendim ankuesit dhe UNMIK-ut. Në komunikatën drejtuar UNMIK-ut, Paneli u referohet neneve 17.3 dhe 17.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12. Neni 17.3 parasheh që PSSP-ja të ketë autoritetin ekskluziv dhe diskrecionin për të vendosur nëse do të ndërmarrë veprime për të gjeturat e Panelit, kurse neni 17.4 parasheh që vendimet e PSSP-së të “shpallen menjëherë në anglisht, shqip dhe serbisht, në mënyrën e cila siguron shpërndarje dhe qasje të gjerë.” Që nga viti 2010, UNMIK-u ka publikuar vetëm një komunikatë për shtyp në përgjigje të mendimeve të miratuara nga Paneli.¹⁸ Në praktikë, kjo do të thotë se UNMIK-u nuk ka reaguar publikisht për pesë mendimet e Panelit të nxjerra në vitin 2011, ku Paneli konstatoi shkelje të të drejtave të njeriut për të cilat ngarkohet UNMIK-u. Paneli është i shqetësuar për mosreagimin publik të UNMIK-ut ndaj rekomandimeve të Panelit. Pa një reagim të tillë, nuk përmbillet tërësia e procesit e paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12. Paneli shpreson se duke vazhduar procesin tutje në vitin 2012 dhe më gjatë, PSSP-ja do të ripërtërijë zotimet e UNMIK-ut ndaj ankuesve dhe ndaj opinionit të gjerë publik dhe informacionet e tilla do t’i publikojë.

¹⁸ Për informacione të mëtejshme për këtë përgjigje të UNMIK-ut, shih Raportin vjetor të Panelit 2010, § 122 dhe si vijon, në dispozicion në <http://www.unmikonline.org/hrap/Eng/Pages/Annual-Report.aspx>.

Shtojcat

Shtojca A: Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, më 23 mars 2006

Shtojca B: Urdhëresa administrative e UNMIK-ut nr. 2009/1, për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, e datës 17 tetor 2009

Shtojca C: Ankesat e HRAP-it të pranuar sipas vitit

Shtojca D: Lëndët e mbyllura të HRAP-it (Të papranueshme, ose mendime për bazueshmërinë) sipas vitit

Shtojca E: Grafiku i HRAP-it për rrjedhën e lëndëve

Shtojca A: Rregulloria e UNMIK –ut No. 2006/12

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

UNMIK/REG/2006/12
23 March 2006

RREGULLORE NR. 2006/12

MBI THEMELIMIN E PANELIT KËSHILLDHËNËS PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke pasur parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Me qëllim të themelimit të Panelit këshilldhënës për të drejtat e njeriut, si organ i përkohshëm gjatë mandatit të UNMIK-ut, për shqyrtimin e shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut nga ana e UNMIK-ut,

Me anë të kësaj shpall Rregulloren në vijim:

KAPITULLI I: Themelimi dhe kompetencat e Panelit këshilldhënës mbi të drejtat e njeriut

Neni 1

Themelimi i Panelit këshilldhënës mbi të drejtat e njeriut

1.1 Me këtë themelohet Paneli këshilldhënës mbi të drejtat e njeriut (Paneli këshilldhënës)

1.2 Paneli këshilldhënës shqyrton ankesat e çdo personi apo grupit të personave të cilët pohojnë se janë viktime të shkeljes së të drejtave të njeriut nga UNMIK-u sikur që është dhënë në njërin apo në më shumë instrumentet vijuese:

- (a) Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e datës 10 dhjetor 1948;
- b) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të datës 4 nëntor 1950 bashkë me Protokollet e saj;
- (c) Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike e datës 16 dhjetor 1966 bashkë me Protokollet e saj;
- (d) Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e datës 16 dhjetor 1966;
- (e) Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor e datës 21 dhjetor 1965;
- (f) Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave e datës 17 dhjetor 1979;
- (g) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve të tjera Më të Rënda, Çnjerëzore apo Degraduese e datës 17 dhjetor 1984 dhe
- (h) Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve e datës 20 dhjetor 1989.

1.3 Pas përfundimit të shqyrtimit të një ankese, Paneli këshilldhënës ia dërgon konkluzionet e veta Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm. Konkluzionet e Panelit këshilldhënës, të cilat mund të përfshijnë rekomandime janë të natyrës këshilldhënëse.

Neni 2

Kompetencat e përkohshme dhe territoriale

Paneli këshilldhënës ka kompetenca në gjithë territorin e Kosovës dhe për ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e supozuara të të drejtave të njeriut që janë bërë pas datës 23 prill 2005 apo që kanë rrjedh nga faktet e paraqitura para kësaj date dhe që këto fakte rrisin në vazhdimësi shkeljen e të drejtave njerëzore.

Neni 3

Kriteret për pranimin e ankesës

3.1 Paneli këshilldhënës mund të trajtojë një çështje vetëm pasi të ketë konkluduar se janë ndjekur të gjitha rrugët tjera të mundshme për shqyrtimin e shkeljes së supozuar dhe brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh nga data kur është marrë vendimi i formës së prerë.

3.2 Paneli këshilldhënës nuk shqyrton ankesën që është:

(a) anonime ose

(b) kryesisht e njëjtë me një çështje që tanimë është shqyrtuar nga Paneli këshilldhënës dhe nuk përmban informata të reja përkatëse.

3.3 Paneli këshilldhënës shpall si të papranueshme çdo ankesë të cilën e konsideron se nuk është në përputhshmëri me të drejtat e njeriut, të përcaktuara në një apo në më shumë instrumente të përmendura në nenin 1.2 lart dhe e konsideron si të pabazë ose shpërdorim i së drejtës së ankesës.

KAPITULLI 2: Përbërja dhe statusi i Paneli këshilldhënës mbi të drejtat e njeriut

Neni 4

Selia dhe përbërja

4.1 Paneli këshilldhënës e ka selinë në Prishtinë.

4.2 Paneli këshilldhënës përbëhet prej tre anëtarëve nga të cilët njëri emërohet kryesues. Së paku një anëtar i Panelit këshilldhënës duhet të jetë femër.

4.3 Anëtarët e Panelit këshilldhënës janë juristë ndërkombëtarë me karakter të lartë moral, paanshmëri dhe integritet, të dëshmuar si ekspertë në fushën e të drejtave të njeriut, në veçanti në sistemin evropian.

Neni 5

Emërimi i anëtarëve

5.1 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm emëron anëtarët e Panelit këshilldhënës pas propozimit të bërë nga Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

5.2 Anëtarët emërohen me mandat dy (2) vjeçar. Emërimi mund të vazhdohet edhe për një mandat tjetër dyvjeçar (2).

Neni 6

Dhënia e betimit solem

Me rastin e emërimit, çdo anëtar i Panelit këshilldhënës e nënshkruan deklaratën në vijim para Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm ose para personit të caktuar nga ai:

“Solemnisht deklaroj se:

“Do t’i përmbahem ligjit gjatë gjithë kohës së ushtrimit të funksioneve në postin tim dhe do të veproj në pajtim me standardet më të larta profesionale e respektin më të lartë ndaj dinjitetit të postit tim dhe detyrave që më janë besuar.

Në ushtrimin e funksioneve të postit tim gjithmonë do të mbështes standardet më të larta të pranuar ndërkombëtarisht mbi të drejtat e njeriut, përfshirë ato të paraqitura në parimet e Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut, në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut bashkë me Protokollet e saj, në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike bashkë me Protokollet e saj, në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, në Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, në Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore apo Degraduese dhe në Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve”.

Neni 7

Imuniteti dhe pacenueshmëria

7.1 Zyrat e shfrytëzuara nga Paneli këshilldhënës janë të pacenueshme. Arkivi, lëndët, dokumentet, komunikimet, prona, fondet dhe pasuritë e Panelit këshilldhënës kudo që të vendosen dhe nga kushdo që të mbahen janë të pacenueshme dhe të mbrojtura nga bastisja, marrja, sekuestrimi, konfiskimi, shpronësimi ose nga çfarëdo forme tjetër e ndërhyrjes përmes veprimit ekzekutiv, administrativ, gjyqësor a legjislativ.

7.2 Anëtarët e Panelit këshilldhënës kanë imunitet të njëjtë si personeli i UNMIK-ut sipas neneve 3.3 dhe 3.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/47 mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë.

7.3 Sekretari i Përgjithshëm ka të drejtë dhe përgjegjësi t’ia heqë imunitetin e anëtarit të Panelit këshilldhënës në çdo rast që, sipas mendimit të tij, imuniteti do të pengojë rrjedhat e drejtësisë dhe ai mund të hiqet pa cenuar interesat e UNMIK-ut.

Neni 8

Burimet financiare dhe njerëzore

Për funksionimin efikas të Panelit këshilldhënës merren masat e duhura përmes sigurimit të burimeve të nevojshme financiare dhe njerëzore.

Neni 9
Sekretariati

Panelit këshilldhënës ka sekretariatit me orar të plotë.

KAPITULLI 3: Procedura e punës së Panelit këshilldhënës mbi të drejtat e njeriut

Neni 10
Parashtrimi i ankesave dhe përfaqësuesit sipas detyrës zyrtare

12.1 Komunikimet ndërmjet Panelit këshilldhënës dhe ankuesit ose personit që vepron në emër të tij janë të fshehta.

12.2 Fshtësia e komunikimit siç paraqitet në nenin 12.1 zbatohet në tërësi kur ankuesi ose personi që vepron në emër të tij është në paraburgim.

Neni 11
Parashtresat me shkrim

11.1 Ankesa paraqet të gjitha faktet e rëndësishme mbi të cilat bazohet shkelja e supozuar e të drejtave të njeriut. Ankesës mund t'i bashkëngjiten edhe dokumente të tjera si dëshmi.

11.2 Pas marrjes së ankesës Paneli këshilldhënës përcakton se a është ankesa e pranueshme. Nëse informacionet e dhëna me ankesën nuk mundësojnë që të bëhet një konstatim i tillë, Paneli këshilldhënës kërkon informacione shtesë nga ankuesi. Nëse Paneli këshilldhënës konstaton se ankesa është e papranueshme, ai merr vendim me të cilin refuzohet ankesa.

11.3 Kur Paneli këshilldhënës konstaton se ankesa është e pranueshme, ai ia referon ankesën Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në mënyrë që të merret një përgjigje në emër të UNMIK-ut lidhur me ankesën. Përgjigja e tillë i jepet Panelit këshilldhënës brenda njëzet (20) ditësh nga dita e pranimit të ankesës nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

11.4 Paneli mund të kërkojë nga ankuesi dhe UNMIK-u që të bëjnë parashtresa tjera me shkrim brenda afateve kohore që ai mund t'i caktojë nëse këto parashtresa janë në interes të drejtësisë.

Neni 12
Fshehtësia e komunikimeve

12.1 Komunikimet ndërmjet Panelit këshilldhënës dhe ankuesit ose personit që vepron në emër të tij janë të fshehta.

12.2 Fshehtësia e komunikimit siç paraqitet në nenin 12.1 zbatohet në tërësi kur ankuesi ose personi që vepron në emër të tij është në paraburgim.

Neni 13
Pjesëmarrja e një *Amicus Curiae* dhe e avokatit të popullit

13.1 Paneli këshilldhënës, kur është në interes të drejtësisë, mund të ftojë

(a) Një *amicus curiae* që të parashtrijë komentet me shkrim dhe

(b) Avokatin e popullit që të parashtrijë komentet me shkrim nëse ai është duke u marrë me këtë çështje.

13.2 Parashtresat me shkrim nga avokati i popullit do të jenë pa paragjykime mbi autorizimet, përgjegjësitë dhe obligimet e avokatit të popullit sipas ligjit në fuqi.

Neni 14
Seancat verbale

Kur është në interes të drejtësisë Paneli këshilldhënës mban seanca verbale.

Neni 15
Kërkesat për paraqitjen e personave ose për parashtrimin e dokumenteve

15.1 Paneli këshilldhënës mund të kërkojë paraqitjen e çdo personi, përfshirë edhe personelin e UNMIK-ut, ose parashtrimin e çdo dokumenti, përfshirë dosjet dhe dokumentet që i posedon UNMIK-u, të cilat mund të jenë të rëndësishme për ankesën.

15.2 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm bashkëpunon me Panelin këshilldhënës dhe i ofron atij ndihmën e nevojshme gjatë ushtrimit të pushtetit dhe kompetencave të tij në mënyrë të vaçantë për lëshimin e dokumenteve dhe informatave që janë të rëndësishme për ankesën..

15.3 Kërkesat për paraqitjen e personelit të UNMIK-ut ose për parashtrimin e dokumenteve të Kombeve të Bashkuara i bëhen Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm. Gjatë marrjes së vendimit për t'iu përgjigjur këtyre kërkesave Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm merr parasysh interesin e drejtësisë, promovimin e të drejtave të njeriut dhe interesat e përgjithshme të UNMIK-ut e të Kombeve të Bashkuara.

Neni 16

Seancat publike dhe qasja në dokumentet e deponuara në Panelin këshilldhënës

16.1 Seancat e Panelit këshilldhënës janë publike përveç në rastet e jashtëzakonshme kur Paneli këshilldhënës vendos ndryshe.

16.2 Pas miratimit nga Paneli këshilldhënës, dokumentet e deponuara në Panelin këshilldhënës për të drejtat e njeriut mund t'i vëhen në dispozicion çdo personi që ka interes të ligjshëm në çështjen pas paraqitjes së kërkesës me shkrim.

Neni 17

Konkludimet dhe rekomandimet e Panelit këshilldhënës

17.1 Paneli këshilldhënës sjell konkludimet mbi atë se a ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut dhe, kur është e nevojshme, bën rekomandime. Këto konkludime dhe çdo rekomandim i Panelit këshilldhënës i parashtrihen Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

17.2 Konkludimet dhe rekomandimet e Panelit këshilldhënës botohen me kohë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe në mënyrën që siguron shpërndarje të gjërë dhe qasje në to.

17.3 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm ushtron pushtetin dhe diskrecionin ekskluziv për të vendosur se a duhet vepruar sipas konkludimeve të Panelit këshilldhënës.

17.4 Vendimet e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm botohen me kohë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe në mënyrën që siguron shpërndarje të gjërë dhe qasje në to.

Neni 18

Rregullorja e punës

18.1 Paneli këshilldhënës miraton rregulloren e punës për procedurat e veta. Rregullorja e punës mund t'i jepë autorizime dhe përgjegjësi sekretariatit të Panelit këshilldhënës.

18.2 Pas miratimit nga Paneli këshilldhënës, rregullorja e punës publikohet me kohë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe me qëllim të shpërndarjes së gjërë dhe qasjes në to.

KAPITULLI 4: Dispozitat përfundimtare

Neni 19 Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të shpallë çdo udhëzim të nevojshëm administrativ për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 20 Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 21 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 23 mars 2006, përveç nenit 10 i cili hyn në fuqi me 23 prill 2006.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Shtojca B: Urdhëresa administrative e UNMIK-ut nr. 2009/1

UNITED NATIONS

United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES

Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au
Kosovo

UNMIK/DIR/2009/1

17 October 2009

URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2009/1

**PËR IMPLEMENTIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UR NR. 2006/12 MBI
THEMELIMIN E PANELIT KËSHILLËDHËNËS PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP),

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me nenin 19 të Rregullores nr. 2006/12 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), të datës 23 mars 2006 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2007/3, të datës 12 janar 2007 (Rregullorja),

Duke marrë parasysh Rregulloren e Punës të miratuar më 5 shkurt 2008 nga Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, në pajtim me nenin 18 të Rregullores,

Me qëllim të qartësimit të karakterit dhe rregullimit të procedurave të dëgjimeve publike të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, shqyrtimin e pranueshmërisë së ankesave nga ky Panel dhe caktimin e një afati kohor për paraqitjen e ankesave pranë këtij Paneli, Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, duke pasur parasysh kapacitetin e zvogëluar të UNMIK-ut që të ushtrojë autoritet ekzekutiv në mënyrë efektive në të gjitha fushat nga ku burojnë çështjet e ankesave për të drejtat e njeriut,

Me anë të kësaj nxjerr këtë Urdhëresë administrative,

Neni 1
Dëgjimet publike

1.1 Dëgjimet publike të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (Paneli Këshillëdhënës) do të drejtohen në mënyrën dhe përbërjen që qartazi do të lënë të kuptohet se janë procedura joadversiale dhe që do t'ju përcillen të gjithë pjesëmarrësve si dhe opinionit të gjerë publik, duke përfshirë edhe mediat e pranishme, nëse prania e tyre lejohet nga Paneli Këshillëdhënës.

1.2 Gjatë dëgjimeve publike, ankuesve apo përfaqësuesve të tyre do t'ju lejohet të bëjnë deklarata duke përmbledhur pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut, ashtu siç është paraqitur në parashtrësën me shkrim pranë Panelit Këshillëdhënës. Gjatë dëgjimeve publike, Paneli Këshillëdhënës mund t'ju parashtrojë pyetje palëve ose përfaqësuesve të tyre të cilat qartësojnë bazën faktike të ankesës, dhe që për Panelin Këshillëdhënës janë të nevojshme që në tërësi të vlerësojë pohimin për shkeljen e të drejtave të njeriut të paraqitur pranë tij.

1.3 Vendi dhe rregullimi i ulëseve për dëgjimet publike të drejtuara nga Paneli Këshillëdhënës janë në përputhje me natyrën joadversiale të procedurës.

Neni 2

Çështjet e pranueshmërisë

2.1 Në cilëndo fazë të procedurës së një ankesë mbi të drejtat e njeriut të paraqitur pranë tij, Paneli Këshillëdhënës shqyrton të gjitha çështjet e pranueshmërisë së ankesës para se të shqyrtojë bazueshmërinë e rastit.

2.2 Çdo ankesë e cila është apo mund të jetë në të ardhmen çështje e procesit të ankesave të palës së tretë ose procedurave sipas nenit 7 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/47 mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë, të datës 18 gusht 2000, do të konsiderohet e papranueshme për arsye se procesi i ankesave të palës së tretë të KB-së dhe procedura sipas nenit 7 të Rregullores nr. 2000/47 janë mjete në dispozicion sipas nenit 3.1 të Rregullores.

2.3 Pas çdo vendimi të ri mbi pranueshmërinë e rastit, Paneli Këshillëdhënës vendimin e tillë të ri ia referon Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm me qëllim të marrjes së komenteve shtesë për ankesën.

Neni 3

Emërimi dhe dorëheqja e anëtarëve të Panelit

3.1 Kryetari i Gjykatës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut do të propozojë një numër të mjaftueshëm të kandidatëve të përshtatshëm për emërim sipas nenit 5 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2006/12, në pajtim me rregullat e zbatueshme të prokurimit të KB-së, pas marrjes së kërkesës nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Nëse UNMIK-u nuk merr asnjë propozim apo merr numër të pamjaftueshëm të propozimeve brenda një muaji kalendarik nga kërkesa e tillë, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të bëjë emërimin e nevojshëm pa propozimin e kërkuar dhe pas konsultimeve me organet relevante ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.

3.2 Nëse një apo më shumë anëtarë të Panelit Këshillëdhënës japin dorëheqje nga postet e tyre, Paneli nuk merr asnjë vendim derisa të bëhen emërimet e reja duke ia mundësuar Panelit të arrijë numrin e parashikuar të anëtarëve.

Neni 4
Publikimet e Panelit Këshillëdhënës

Të gjitha publikimet, njoftimet dhe komunikatat për shtyp të Panelit Këshillëdhënës bëhen përmes zyrës së zëdhënësit të UNMIK-ut dhe informimit publik, që e ndihmon Panelin Këshillëdhënës në njoftimet e tij zyrtare mbi të gjitha çështjet.

Neni 5
Data e prerë për parashtrimin e ankesave


Pavarësisht nga neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, asnjë ankesë dorëzuar Panelit Këshillëdhënës nuk do të jetë e pranueshme nëse pranohet nga Sekretariati i Panelit Këshillëdhënës më vonë se 31 mars 2010.

Neni 6
Hyrja në fuqi


Kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi më 17 tetor 2009 dhe është e zbatueshme për të gjitha ankesat e dorëzuara Panelit Këshillëdhënës, duke përfshirë edhe ato të cilat janë në pritje për t'u shqyrtuar nga Paneli Këshillëdhënës.

Lamberto Zannier
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Shtojca C: Ankesat e HRAP-it të pranuar sipas vitit



Shtojca D: Rastet e mbyllura të HRAP-it (Të papranueshme, ose mendimet për bazueshmërinë) sipas vitit



Shtojca E: Grafiku i rrjedhës së lëndëve pranë Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut

